

FJALIMET E EDI RAMËS NË DIASPORË

Ideologji dhe metodologji për:

- Përçarjen globale të diasporës shqiptare
- Dekurajimin e punës kombëtare
- Dekurajimin e kthimit në atdhe
- Asimilimin e shpejtë kombëtar
- Indiferentizimin ndaj gjuhës shqipe



Nga ARTUR SHKURTI

Analizë e fjalimit në Itali, maj 2024






GLOBAL ALBANIA



udha e shkronjave

KONCEPT
NGA ARTUR SHKURTI



POROSITË E GJON KASTRIOTIT

Nga Naim Frashëri, Histori e Skënderbeut



S'më vjen keq për derët t'ënë
se nga Zoti kshu qe thënë,
po më vjen për Mëmëdhenë
dhe për besën' e për fenë,
më vjen keq për njerëzinë
që i dhatë arratinë.

Tregomu dhe Shqipëtarët
udhën' e punës së mbarë,
Bashkomi, bëmi vëllezër,
edhe fjeshtë Shqipëtarë

Perëndija Shqipërinë
e bëri për shqipëtarët,
s'e bëri për djallëzinë,
për të liqt' e për kusarët.



*Atdheu është trashëguesi i vërtetë i njeriut,
madje edhe eshtrat e tij i mbeten atdheut.*

SAMI FRASHËRI

Gjon Kastrioti:

“Ah! kam frikë prej mynxyre!
mos nuk' i shoh më në jetë,
e të vdes nga mall' i tyre,
ta lë dhe shtëpinë shkretë!”

Pastaj djemtë pran' i mori,
i puthi e i qafojti,
psherëtit fort i gjori,
lottë çurkë i lëshojti.

U thotë: “Të silli mirë,
të bëhi njerës në jetë,
të mos mbetni n'errësirë,
po të jini të vërtetë.

Nat' e ditë të këndon
çdo q'u duhet ta dini,
gjithë gjuhët t'i mësoni,
po shqipenë mos e lini;

Mirësit' e Shqipërisë
i mbani, mos i harroni.
Mëmëdhen' e kombin tuaj,
shtëpinë e njerëzinë
dhe atje në vënt të huaj
t'i doni, dhe miqësinë;

Shqipëtar' e Shqipërinë
kurrë të mos i harroni,
kini dritë urtësinë
çdo gjë me mënt ta gjykoni;

Të bëhi trima të urtë,
të zottë të mbretëroni,
jo të marr' e mendjeshkurtë,
ndaj duhetë të mësoni,

Të bëhi shumë të ditur,
fjalëbukur' e të çquar,
shpirtdashur' e mendjendritur,
të mir' e të kupëtuar.

Zoti e nderoj njerinë,
i dha mënt që të gjykonjë,
të punonjë mirësinë,
të ligatë t'i mërgonjë.

Ruani nder' e shëndenë,
burrërin' e trimërinë,
kombin' edhe mëmëdhenë,
njerëzin' e mirësinë.

Shqipërija jush ka shpresë,
edhe pret shumë të mira,
po të mbani juve besë,
nuk' e ha dot egërsira.


Mësimet do t'u mësojnë
ato punëra, q'u duhen
atyre që mbretërojnë,
e mbretërë të mirë quhen;

U duhetë njerëzija,
zotërija e të tjera,
mirësija, trimërija,
gjithë vetijat' e vlera;

Kombinë shumë ta doni,
e si fëmijë ta kini,
me të drejtë të gjykoni,
e çdo punëzë ta dini;

Dhe në brengë të mësohi,
dhe shpirtinë ta mundoni,
e kurrë të mos rëndohi
në doni të mbretëroni;

Kini njohë të qëruar,
dhe ndjenja të larta shumë,
zëmër edhe shpirt të çquar,
mëndje pa lodhje e pa gjumë”.



Ndre Mjeda

GJUHA SHQYPE

Përmbi za që lëshon bylbyli
Gjuha shqype m'shungullon;
Përmbi erë që nep zymbyli
Pa da zemrën ma ngushllon.

Ndër komb tjerë, ndër dhena tjera
Ku e shkoj jetën tash sa mot,
Veç për ty m'rreh zemra e mjera
E prej mallit derdhi lot.

Njikto gjuhë që jam tuj ndie
Janë të bukra me themel;
Por prap kjo, si diell pa hije
Për me t'tanave ju del.

Por gazmo ndër gjith'kto t'vështira
Përse ende s'sharrove krejt;
Diçka t'mbet ndër ato t'mira
Mbas dy mij' e ma shum vjet.

Geg' e Toskë, Malci jallia
Jan' një komb, m'u da s'duron:
Fund e majë një a Shqypnia,
E një gjuhë t'gjith' na bashkon.

Kjoft mallkue kush qet ngatrrime
Ndër kta vllazën shoq me shoq:
Kush e dan me fjal' e shkrime
Ça natyra vetë përpoq.

I TRETUNI

Me shí pshtjellun acarija
Permbî bjeshkë po shungullon;
E prei maleve stuhija
Ujët e détit e pervëlon.

Mal e rë, porsì dy zdapa,
Ngrehin luftë qi gjâ se pret;
Gjimon moti e parë mbrapa
Mndershem rrféja po kërset.

Po këjo gjâmë qi bân natyra,
Këjo duhí qi s'ká pushim,
E kësaj zëmres â pasqyra,
Â pasqyra e vâjít t'im.

Porsìj' ujk qi natën turret
E mbas deleve luron,
Kërkon mal e kërkon shkurret
Déri sá ndo'j vathë rrmon;

Kênka thanë m'u lëshue mizori
Mbi krye t'ëmin pá një faj;
Kênka thanë me pshtue fajtori
E me hup kush s'â si aj.

E me lanë njat vënd qi dritën
E këtij shekullit m'përftoj,
M'u largue prei asish qi m'rriten,
Qi kurr zëmra si harroj.

O ti diell, qi pá një hije
Mbi Bjeshkë t'Nënuma shkelxën
Për mue ndoshta atâ shkambije
S'ké me i shndritë kah shkon e vjen.

Val' e Drinit rrotullore,
Qi për mal e fusha bje;
E ti e Buenës rrjedha qetore,
Jo, s'do t'mshifni kurr atjë.

Porsì rë qi tret duhija
M'ikë, o shqype, vëndi i jot;
E kurr mâ nder ditt e mija
Ndoshta n'tý nuk piqem dot.

Lamtumirë, o mori Shkodrë!
Lamtumirë, o ti Cukal!
Zhduket Buena nen një kodrë
Zhduket Drini nen një mal.

Lamtumirë, o ti nanë shkreta
Qi me t'vstira m'rrité kaq,
N'kohë mâ t'mirë per tý un treta,
Kúr pleqnija kërkon paq.

Veshn'ju lule, qi ju vûna
Me kujdes n'at kopshtin t'ëm;
Tretni zogj, qi' i ditë ju xûna
Tui flutruet gëmb mbi gëmb.

E ti grunë, qi muell buqari
Me djersë t'ballit e t'punoj,
Thai per hânë, o te mbloftë bari,
Se un tý kurr mâ nuk t'kërkoj.

Por ju, dele, qi blegroni
N'bjeshkë n'vrrî me tuba shpesh,
Shton'ju, shton'ju e lerg m'i çoni
Për tregtarë do bashka lesh.

Hapi n'bjeshkë, çetinë mbretnore,
Hapi gëmbat, kând e kând;
Trashu, shparth, me trup e lëvore,
Lëshoju, bré me at shtatin tând.

Ndoshta 'j ditë n'një breg te thyeshëm
Ndo'j lundric' o'j barkë shtegton;
Drûnin t'uej, per shêj t'mallënjyeshëm
Barka o lundra ma difton.



MËMËDHEU

Mëmëdhe quhet toka,
 Ku më ka rënurë koka,
 Ku kam dashur mëm' e atë,
 Ku më nje dhe gur' i thatë,
 Ku kam pasur shtëpinë,
 Ku kam njohur Perëndinë,
 Stërgjyshët ku kanë qënë,
 Dhe varret q'i kanë vënë,
 Ku jam rritur me thërime,
 Ku kam folur gjunë time,
 Ku kam fis, e ku kam farë,
 Ku kam qeshur, ku kam qarë,
 Ku rronj me gaz e me shpresë,
 Ku kam dëshirë të vdesë.



ANDON ZAKO ÇAJUPI

*Dhe rrugët zgjaten e zgjaten në veri
 Ne, popull muhaxhir, ecim nëpër shi.*

BILAL XHAFERRI



Shum' i hidhur, shum' e shumë,
 mirpo imi më për lumë.
 Kam një dert që s'thuhet sheshit,
 un' kam dertin e arbreshit!

ALI ASLLANI

Vendi ynë që ka jetuar herë me pushkë e her me shat,
 s'mund të lihet tash e tutje si një flet' në dëgë të that',
 Ai lipset që të rrojë, qoft' me hir' e qoft' pa hirë,
 dhe aty ku bie zjarri, bëhet lulja më e mirë.

BESA JONË

Qjell me shkaba shqipëtar!
 Male mbushur me dragona!
 Këto fusha derdhur n'ar,
 Deti plot margaritar
 Këto janë viset t'ona!

Këtu leu që në fillim
 Trim'i dheut si zog i shkruar;
 Leu dh'u la për trashëgim
 - Me nderim e me qëndrim -
 Besa jon' e shentëruar.

Ha! dhe'e bukura liri
 Këtu mbretëroj përjetë:
 Mbretëroj: e plot mëri,
 Bëri në rezik të zi
 Prej kujtdo një trim me fletë.

LASGUSH PORADECI


Atje më s'do zgjohem unë
 luleve që i përkund era
 si suvalë të pasosje.
 Do të mblidhen shokët mbrëmjes
 në qytet, në vatrat tona.
 Unë si nj'ëndërrzë i lë!
 Të Milosaut s'ka më."

JERONIM DE RADA

Gjithë më thonin se kjo dit' do vinte,
 por unë s'pata besë që të arrinte.
 Tani po ikën me kalin flutur n'erë,
 Si ëndërr t'ëmbël, ti merrmë përherë.
 Në vend të huaj, arbrishten s'do ta ndjesh,
 Shtëpinë e kopshtin tënd nesër s'do gjesh.
 Nderime si këtu, s'do kesh atje ti,
 O zemërgur, përse me ne nuk rri.

JERONIM DE RADA





GJERGJ FISHTA

GJUHA SHQYPE

Pra, mallkue njai bir Shqyptari,
 Qi ketë gjuhë të Perëndis,
 Trashigim, qi na la i Pari,
 Trashigim s'i a len ai fmis;
 Edhe atij i u thaftë, po, goja,
 Qi e përbuzë kët gjuhë hyjnore;
 Qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
 Flet e t'veten len mbas dore.
 Në gjuhë shqype nanat t'ona
 Shi prej djepit na kanë thanun,
 Se asht një Zot, qi do t'a donna:
 Njatë, qi jeten na ka dhanun;
 Edhe shqyp na thanë se Zoti
 Per Shqyptarë Shqypnin e fali,
 Se sa t'enden stina e moti,
 Do t'a gzojn kta djalë mbas djali.
 Pra, Shqyptarë, çdo fes qi t'jini,
 Gegë e Toskë, malci e qyteta,
 Gjuhen t'uej kurr mos t'a lini,
 Mos t'a lini sa t'jetë jeta,
 Por per te gjithmonë punoni;
 Pse, sa t'mbani gjuhen t'uej,
 Fisi i juej, vendi e zakoni
 Kanë me u mbajtë larg kambet s'huej.
 Nper gjuhë shqype bota mbarë
 Ka me u njohtë se ç'fis ju kini,
 Ka me u njohtë ju per Shqyptarë:
 Trima n'za sikurse jini.
 Prandej, pra, n'e doni fisin,
 Mali, bregu edhe Malcija
 Prej njaj goje sod t'brohrisin:
 Me gjuhë t'veten rrnofhtë Shqypnija!

STUDENTIT BURSIST

Ernest Koliqi

Eja t'i thejm' djerrinat
 edhe t'a zgjojm' prendverën
 n'kto vise kaq t'shkretnueme;
 eja t'a mbushim erën
 me ethet e veprimit
 qi sjell shndet e lumni
 e lavd e dritë e frymën
 e t'bardhes qytetni;

Eja t'a ndrojmë ankimin
 n'nji hymn uzdaje, eja
 t'ndërtoj'm permbi gërmadha
 faletoret e reja,
 ku me vallet e moçme
 t'a qarkojm' çdo therore,
 me vllaznit ma t'përvujtun
 t'kapun lirisht për dore;

Eja t'i falim lule
 edhe jetës shqiptare,
 t'zgjojm' n'te qejfet e lehta,
 mirakandet bujare,
 ngjyret e gjalla, jonet
 e bukra, drandofillet
 e gzimit ndër të cilat
 jeta e përjashtme shtiellet.

E atbot' dhe toka e t'parve
 shpirtin ka me na knaqë:
 na t'rijt atbot'ndërgjegjen
 duhet t'a kemi n'paqë.

Veç kshtu mundin ktij popull
 ti mundesh m'i a shpërblye:
 përndryshej tash t'vret djersa
 qi qe dikue për tye.



ERNEST KOLIQUI

Ndoshta m'ka marrun gjumi tue lexuemun,
 o Dant, poemën t'and me duer ndër tamtha,
 pse nesër n'klasën t'ime më vjen rendi
 t'zhvilloj at vargun plot me lot, at vargun
 e mërgimit: *“Sa fort i ndiehet krypa
 bukës së huej edhe sa shteg i ngurtun
 asht zbritja e ngjitja nëpër shkalla t'hueja ...”*


Un sakt jam n'andërr e mërgimi i Dantit
 m'ban t'a shof veten n'nji dhe t'hueja ...”

Un sakt jam n'andërr e mërgimi i Dantit
 m'ban t'a shof veten n'nji dhe t'huej mërgue ...
 por tekembramja mue kumbonza e shkollës,
 qi vje n'çdo orë e na kallzon detyrën,
 ka me m'a hjek'kët angh kur do t'më zgjoje
 n'mes shokve t'dashun të kolegjes s'eme ...

Ah jo, or mik, vërte jan'kumbon' t'hueja
 qi qajn' tue tingullue n'nji qiell mërgimi ...

Sot sheklli mbarë prir synin prej Shqyptarvet,
 Me pa si perkujdesmi per Atdhe;
 E si u dishmojm me punë na kundershtarvet
 Se jemi t'zott me u lidhe me besë e fe
 Edhe vetë me sundue vendin e t'Parvet

GJERGJ FISHTA



Jam lark jush i dëshëruar,
edhe s'e duronj dot mallë,
Po s'e di si dua unë
do t'u shoh një herë vallë?

Të munjam të fluturonja
e të kishnjam krahë si ti!
Me gas të math do t'i vinjam
Shqipërisë brenda në gj.

Shqipëri! të qofsha falë!
Të kam mëm' e më ke djalë.

NAIM FRASHËRI

ANDON ZAKO ÇAJUPI

Në ç'vend kemi lerë?
Ku na bëjnë nderë?
Në Shqipëri.

Po njeriu vetë
Cilinë do në jetë?
Do vend' e ti.

Ku i duket balta
M'e ëmbël se mjalta?
Në Shqipëri.

Ku rron me një shpresë?
Ku kërkon të vdesë?
Në vend të ti.

Kam fort mall për
Shqipërinë,
për miq edhe për të njohur,
e për gjithë njerëzinë,
i kam lottë të pashtrohur;
Shumë kohë këtë herë
shkoj pa marrë ndonjë kartë,
zëmërn' e ndjen fort të mjerë,
edhe nga malli të zjarrtë;

Zëmrënë dhëmbja ma
mbushi
me helm e me hidhërimë,
pa më digjetë si prushi,
e kam plot me mallëngjime,
për motërat' e për farët,
për vëllezër' e të tjerë,
dhe për gjithë shqipëtarët,
e për mëmëdhen' e mjerë.

Aqë kam një mall të shumë
për Shqipërit nat' e ditë,
sa s'kam as prehje as gjumë,
më gjeti si çilimitë!
NAIM FRASHËRI



Ku munt të gëzojë
Dhe me nder të rrojë?
Në Shqipëri.

Përse të punojë
Dhe të lakëmojë?
Për vënd' e ti.



Se pas dimrit vjen një verë,
Që do t'kthehemi një herë,
Pranë vatrës, pranë punës,
Anës Vjosës, anës Bunës.

FAN NOLI



PASHKO VASA

NDIHMA NDAJ DESPOTIT

Mes kënaqësive dehet
mendja, e humb fuqinë,
molisen fare shpirtrat,
njeriu t'zezën s'e ndien,
dhe meqë i do gëzimet,
i kënaqur dhe i përtuar,
harron se është robëruar
se atdhe ai më nuk ka;
e n'kaq duron te qafa
një zgjedhë që s'meriton,
edhe pa ditur asfare
despotin e ndihmon.
Të tillë bisedë u mban:
“Gëzo, o ti i zdërhallur,
ti popull skllëvërisht, dehu,
zhytu me trup e shpirt,
ligshtu ato kocka e deje,
ndër qejfe, me gjithë zemër
për t'mirën tuaj veprojmë,
në gjumë ne mirë t'ju vëmë
helm t'ëmbël ne ju shtrojmë.
Gëzoni, pra, dhe shporruni
nga ajo mendjemadhësi
e atdheut edhe e lirisë ...
Lindët për skllavëri!
E n'qe se ju kënaqeni
që ju trajtojmë kaq mirë,
ç'kërkoni më? Të shtrirë
shërbeni n'altar tonë!”



SKËTERRA

Naim Frashëri - Histori e Skënderbeut

s'kanë pasur mëshirë,
kafshët' i kanë munduar,
nukë bënë gjë të mirë,
s'patnë zëmrë të qëruar;

fjalënë e kanë thyer
e s'kanë mbajturë besë,
kanë rrejtur' e gënjyer,
andaj Zoti s'u dha pjesë.

Ca i pru makutërija
e të tjerëtë kurcimi,
ca nakari e zilija
dhe ca dëmi e mundimi.

I sheh ata që mundohen?
S'rrëfeketë ç'kanë bërë!
dit' e natë përvëlohen!
se qenë të liq të tërë!

Pa shih atë plakën shtrigë!
si heq brengë dhe mundime!
se ka qënë shumë' e ligë,
andaj ra ndë idhërimë.

U bënë shokë me djallë!
s'patnë turp, të turpërohen,
pa hoqnë dhe më të gjallë,
edhe tani po mundohen!

Harruanë Perëndinë,
zunë djall' e djallëzitë,
punuanë ligësinë,
pa kurrë s'shohënë dritë!"

Kështu tha Ëngjëlli vetë,
pa duallë duke shkuar
të dy me mbren e vërtetë
ng'ajy vent i mallëkuar.

Oh! moj marrëzi e shkretë!
ç'je e lig e shum'e ndyrë:
të shoftë Zotth'i vërtetë!
s'e ç'bije dëm e myxyrë!

Lakëmime! o nëmëshumë!
se ç'e bën ari njerinë!
edhe ti nakar! o lumë!
e gjeçi më Perëndinë!

Në mest të gjithë rremetit,
q' ishte brenda në Skëterrët,
Ëngjëlli i thotë mbretit:
"A i sheh këta të mjerët?"

Jan' ata, që kanë vrarë!
e kanë mbyllurë derë!
dhe kanë rrahur' e sharë!
andaj erdhë në Skëterrë!

Perëndi s'kanë kujtuar!
pa kanë prishurë punë,
njerëzin' e kanë shuar,
kanë qënë të përdhunë!

Nuk' i ndihne varfërisë,
ndonëse patnë fuqinë,
i qen' armik njerëzisë,
kanë bërë ligësinë.

Po malli i Tokës s'më la
po mall i Fushës s'më la
as gjaku i Babës s'më la.

MITRUSH KUTELI



“Shqipëria: ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë”



5. Qëllim’ i shqiptarëvet

“Qëllim i vetëm i shqiptarëvet është të ruajnë Shqipërinë të mos copëtohetë prej të huajve, **të mbajnë gjuhën’ e kombërin’ e tyre** t’u rrinë kundreq entrigavet t’armikëvet të tyre e të ndalojnë të përhapurit’ e gjuhëvet e të mendimevet të greqet e të shqehet, të cilatë po i rëmojnë themeletë e po i nxjerinë rrënjët Shqipërisë dhe shqipëtarërisë.

Çdo gjë që mund t’i sjellë dëm këtij qëllimi do të lëftohetë keq prej çdo shqiptari të vërtetë edhe prej lidhjes së shqiptarëvet. Ato gjërëra, që do t’i ndihinë këtij qëllimi, do të zihenë me të dy duartë prej atyre e do të bëhenë me hir a me pahir.

M’e par’ e këtyre është gjuha; s’mund të ketë Shqipëri pa shqiptar, s’munt të ketë Shqipëtar pa gjuhë shqip, s’munt të ketë gjuhë shqip pa shkronja shqipe, pa shkolla në të cilat mund të mësohetë shqipja.

P’andaj më e parë nga të gjitha do të mbahetë gjuha, të shtrëngohetë qeveri e tyrkut ta grerë ndalinë, q’i ka vënë gjuhësë shqip e të lërë shkollat shqip të hapenë e livrat e fletoretë shqipe të hyjnë e të shkelenë çpënguarë në Shqipëri. Çdo shqiptar të mësonjë më parë të shkruanj’ e të këndonjë shqip, pa pastaj gjuhëra të tjera.

E dyta është kisha: të shpëtohenë shqiptarëtë nga xgjedha e priftërisë së greqet, të bullgarëvet e të serbëvet e të kenë kishën’ e tyre me priftër shqiptarë e me ungjill shqip; se Krishti s’ish as grek, as shqah.

Po për të bërë këto, duhet të qëndronjë (fjala “të hiqet”) qeveri’ e sotme, e të vihet një qeveri mëmëdhetare, një qeveri që të punonjë pas nevojës’ e pas të drejtave të shqiptarëvet. Një qeveri shqiptare me sy të hapurë, e jo qeveri e huaj e e verbër si kjo q’është sot. të jetë një qeveri si duhetë pa le të ketë ç’emër të dojë.

Ky është qëllimi i shqiptarëvet.



TRASHËGIMTARËT E VËLLEZËRVE FRASHËRI
DHE TË RILINDJES KOMBËTARE

Sulm përfundimtar në zemër të kombit

Në këtë artikull, lexuesi do të gjejë fjalimin e plotë të z. Edi Rama, kryeministër i Shqipërisë dhe Kryetar i Partisë Socialiste, të mbajtur në Itali, më 26 maj 2024, në Milano (Busto Arsizio), në prani të mijëra shqiptarëve dhe të transmetuar gjerësisht në media.

Para se ta analizojmë, është me rëndësi të themi që pikëpamjen tonë për punën në diasporë e kemi shprehur para se Edi Rama dhe Partia Socialiste të niste turin, ose ta lajmëronte këtë tur.

Në 29 tetor 2023, në kuadër të Festave Kombëtare, u nisëm ambasadave shqiptare “Programin Edukativ të Shkollave Shqipe”. Në faqet e fundit të kësaj broshure ju do të gjeni edhe tri faqe të atij programi që kanë të bëjnë me tre elementë kyç të këtij programi:

- a) Programi i kthimit në atdhe
- b) Shkolla shqipe si Faltore e Bujarëve Shqiptarë
- c) Mësuesit shqiptarë si figure kryesore të komunitetit (të diasporës)

Ndërkohë që shkollat shqipe që kanë komunikim me ne e mirëpritën dhe dërguan edhe disa përshëndetje të fëmijëve me poezi shqipe të recituara pjesë e programit edukativ, asnjë ambasadë nuk solli një komunikim qoftë edhe formal.

Në 19 prill 2024 botuam librin “Global Albania” dhe e shpërndamë kudo në diasporë. Aty është koncepti ynë i plotë për të gjithë diasporën. Global Albania dhe Programi Edukativ i Shkollave Shqipe, provojnë qartësisht që mënyra si shkruajmë e çfarë propozojmë nuk është politike por kombëtare.

Pra analiza e fjalimit të Edi Ramës bie saktësisht në fushën tonë të specializimit që ia kemi mësuar vetes, pra e kemi dashur të bëhemi profesionalë në këtë drejtim.

Mitingu i Edi Ramës në Itali dhe në Greqi, është organizuar nga Partia Socialiste, në atë mënyrë që t’i shpëtojë filtrave të kontrollit të shteteve pritëse por edhe të opinionit publik shqiptar dhe të huaj si një veprimtari mirëfilli politike dhe të duket si një veprimtari shtetërore ose thjesht patriotike. Do të provohete që nuk ishte as shtetërore, as patriotike, por thjesht politikë e Partisë Socialiste, e më saktë sektit drejtues të kësaj partie.

Kjo formë organizimi pa logo PS-je ndihmonte shoqatat në dukje patriotike të rreshtuara krahas Partisë Socialiste të ftonin sa më shumë të mundshin anëtarësi. Këtë gjë PS-ja mund ta bënte edhe me organizatat e mirëfillta patriotike, por ajo nuk donte të forconte shoqatat “patriotike” por vetëm organizatat socialiste, ndaj zgjodhi një rrugë të tillë organizimi. Kjo qasje (pa logo) do t’i ndihmonte të etektonin si “antikombëtar”, “antishtetëror” ata që nuk vinin në “miting”.



Artur Shkurti

Drejtor i shkollës “Udha e shkronjave”

Disa botime dhe artikuj me fokus të veçantë në diasporën shqiptare:

Libri “Global Albania - një koncept i ri për diasporën” (prill 2024)

Autor i librit “Besa, feja ime e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë” (2009)

“Projektligj për mbështetjen e arsimit shqip në diasporë nga shkollat publike të Shqipërisë dhe të Kosovës”. (Letër për qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës - 12 tetor 2022)

“Gjendja e gjuhës shqipe në diasporë - dobësia e kurrikulës (Shqipëri - Kosovë) përshpejton asimilimin” (14 nëntor 2022)

“Financimi i gjuhës shqipe me buxhet familjar - interes kombëtar” (28 nëntor 2022)

“Për krijimin e shoqatës shqipe të mësuesve të Torontos” - një letër për mësuesit e licensuar të Torontos (nënkupto edhe të Kanadasë). (20 shkurt 2023)

“Fjalimi i Edi Ramës në Greqi - dekurajim i kthimit në atdhe dhe nxitje e asimilimit të shpejtë” (12 maj 2024)

Analizën po e fillojmë nga lutja, këshilla apo porosia e Naim Frashërit, që i drejtohet Zotit, por ndërkohë mund të shihet si një detyrim për çdo shtetetar apo drejtues të vendit. Citoj:

*Tregomu dhe shqipëtarëve
Udhën e punës së mbarë,
Bashkomi, bëmi vëllezër
edhe fjeshtë shqipëtarë.*

ÇORIENTIMI I UDHËS: Provohet edhe me fjalimin në Greqi, më 12 maj 2024, dhe, pas kësaj, edhe me fjalimin që mbajti në Itali, më 26 maj 2024 se synimi i Edi Ramës nuk është “*udha e punës së mbarë kombëtare*” por fshehja e kësaj udhe me “shpëndra, hitra, ferra” dhe çorientimi i plotë i diasporës. Ai nuk tregon asnjë udhë. Ai fsheh udhë dhe udhën duhet ta dijë ai e t’u thotë me tangërllek popullit të tij “nuk keni parë gjë ende”. Kjo do të thotë që është i interesuar në fshehjen e udhës. Kjo sigurisht është qartësisht antikombëtare. Sidoqoftë, ne nuk e dimë më parë udhën, por mund ta pikasimë nga gjurmët se nga po shkohet, dhe ajo që shohim nuk është aspak e përputhur me programin dhe objektivat e Rilindjes Kombëtare, aspak e përputhur me dëshirat e shqiptarëve të diasporës dhe aspak e përputhur me zhvillimet më të mira botërore në çështjen e rëndësisë së ruajtjes së gjuhës, kulturës dhe identitetit kombëtar.

PËRÇARJA: Provohet qartësisht se me mënyrën e organizimit të turit në diasporë, ai nuk i do shqiptarët të jenë bashkë, të jenë vëllezër, bën sikur nuk dëgjon nga ky vesh.

INDIFERENCA NDAJ GJUHËS SHQIPE DHE KULTURËS SHQIPTARE: Provohet se me mungesën skandaloze në fjalim të theksimit të rëndësisë së gjuhës dhe të kulturës shqipe, të kujdesit shtetëror për gjuhën shqipe, shkollat shqipe dhe organizimet patriotike, ai nuk i do që të jenë as shqiptarë.

INKURAJIMI I ASIMILIMIT: Kjo provohet me shembujt që u dha diasporës në Greqi dhe në Itali që të gjithë ishin figura të asimiluara, pra që në vend të punonin për Shqipërinë nderohen për meritat e punës për Greqinë apo Italinë.

Ai dha mesazh të kundërt me mesazhin e Naim Frashërit, i cili thotë:

NAIM FRASHËRI:

*“Të kesh Boçarin, Xhavellën, Miaulin, Bubulinën,
E shumë heronj të tjerë, dhe ata të mos përpiqen
për ty, Shqipëria ime, po për grekët e Greqinë!
O heronj të paharruar, u munduat kot së koti”*

Edi Rama: *Ku ka shembull më të mirë se heroina legjendare e pavarësisë greke Laskarina Bubulina, e lindur në një burg të Stambollit me prejardhje arvanitase, një luftëtare legjendare e lirisë së Greqisë, e para grua admirale në botë, në krye të një flote ushtarake detare. Tani, kush na ndalon ne që të mos jemi njëkohësisht krenarë, bashkë me grekët, për kontributin që i ka dhënë Greqisë ajo grua heroike me prejardhje nga një familje ku flitej shqip.*

DEKURAJIMI I FRYMËZIMIT NGA SHEMBULLI I DIASPORËS SHQIPTARE QË SOLLI RILINDJEN KOMBËTARE

Edi Rama, qëllimisht, shmangu shembullin e fuqishëm pozitiv në historinë tonë kombëtare që lëvizja e Rilindjes Kombëtare që i dha tipare kombit tonë dhe e udhëhoqi atë drejt pavarësisë u organizua kryesisht e masivisht nga diaspora shqiptare. Kjo do të thotë që Edi Rama nuk e do patriotë diasporën shqiptare, nuk e do të merret me punë kombëtare, nuk e do të lidhet në mënyrë agregate globalisht, por e do thjesht “hallexheshë” që aplikon në e-Albania për certifikata, që sheh punët e veta dhe jeton si elektron i lirë dhe jo i organizuar dhe që përthithet nga mekanizmi asimilues i shteteve të fuqishme ku ajo po jeton. Kjo i tremb fuqishëm edhe ata që jetojnë në Shqipëri. Ata nuk duhet të marrin zemër nga lëvizjet e diasporës, ndaj ai dekurajon diasporën duke dhënë mesazhin “Mund të merrem edhe me ju këtu ku jeni”, me të njëjtin mekanizëm që merrem në Shqipëri, por këtë radhë kam në dorë “shoqatat e ashtuquajtura patriotike” por që survejojnë diasporën, bëhem “ndërmjetëse” me “shtetin e partisë socialiste” për të mbaruar halle jo në mënyrë ligjore, por në atë mënyrë që të duket si “nder individual” i njerëzve me pushtet. Ky është eksportim i të tëra tipareve shtetërore tek partia dhe i të tëra partisë tek individët. Kështu as shoqëria nuk ka kontroll mbi shtetin, as shteti mbi partinë dhe as partia mbi individët, por janë këta që kontrollojnë partinë, pastaj në emër të partisë, kontrollojnë shtetin dhe në emër të shtetit kontrollojnë të gjithë shoqërinë.

Puna e çdo shtetari shqiptar që takohet me diasporën është në radhë të parë edukative, derisa synohet që ai të ketë një sjellje të caktuar sipas porosive të shtetit. Tek “Histori e Skënderbeut” Naim Frashëri jep porositë se si duhet të jetë një shtetar. Këtë e bën në gojën e Gjon Kastriotit që u jep porosi fëmijëve që do të shkonin në Stamboll, të marrë nga Sulltani:

*“Kombin shumë ta doni,
e si fëmijë ta kini”*

Më tutje parashikon drejtuesit zemërligë, ndaj shkruan:

*Si të msojnë ligësitë,
e të mirat t'i harrojnë,
të çpikinë djallëzitë,
pastaj të na mbretërojnë?*

Qartësisht e masivisht drejtuesit e klasës politike shqiptar kanë mësuar ligësitë, kanë harruar mirësitë, kanë shpikur djallëzitë dhe po e drejtojnë dhunshëm kombin shqiptar. Këtu jemi.

Në muajin prill, para se të shpallej turi i Edi Ramës dhe i Partisë Socialiste, kam shkruar një libër (broshurë) të titulluar “Global Albania”. Libri ndahet falas në format PDF edhe në faqen e shkollës “Udha e shkronjave”. Synimi kryesor i librit është konceptimi i punës së diasporës shqiptare në atë mënyrë që ajo të bashkohet globalisht në mënyrë agregate përmes organizatave shqiptare, derisa të jetë e aftë të prodhojë me ekspertizë globale një opinion publik të vlefshëm për kombin dhe shoqërinë shqiptar, të tillë që t’i tregojë kombit “udhën e punës së mbarë” (N.Frashëri).

Shtyllat kryesore të punës edukative sipas mendimit tim që i kam të shprehura në librin “Global Albania” (prill, 2024) janë *vetëdija kombëtare, vetëdija globale dhe programi i kthimit në atdhe dhe aftësia për bashkim global në atë mënyrë që të prodhohet një opinion publik kombëtar* që është jo thjesht “mendim” por një ekspertizë globale shqiptare, sipas devizës së Sami Frashërit “Pa bashkim nuk ka opinion publik”.

Në të tërë këta komponentë, fjalimi i Edi Ramës përfaqëson një sulm të qëllimshëm përcarës, *për të dëmtuar aftësinë e diasporës shqiptare për ta quajtur veten të aftë të ndihmojë veten dhe kombin në çështje shqiptare*.

Qëllimisht e në mënyrë të tepruar, Edi Rama, si në Greqi dhe në Itali evokoi vuajtjet individuale, me prapamendimin “e dimë nga keni ardhur”, “e dimë që jeni të lodhur”, e të paaftë për punë kombëtare”.

PUNA E VETME QË I JEP DIASPORËS “JINI VETËM KRENARË” (pra edhe dembelë në punë kombëtare)

Edi Rama nuk i jep asnjë mision dhe asnjë vizion diasporës shqiptare, ndaj fushatën qëllimisht e ka titulluar “Krenarë për Shqipërinë”, që me fjalë të tjera do të thotë: “E vetmja punë që mund të bëjë diaspora shqiptare është “të jetë krenare për Shqipërinë”. Faktet për këtë duhet t’i sjellë propaganda e qeverisë.

Diaspora Shqiptare ka shumë punë për të bërë në çështjen kombëtare. Duhet të ngrejë kurset dhe shkollat shqipe që të mund të trashëgojë “shqiptaren” tek fëmijët që do të marrin në dorë stafetën e kombit. Diaspora duhet të ndërtojë shoqata patriotike. Duhet të lidhet globalisht me shoqatat simotra patriotike në shtetet e tjera. Duhet të ndajnë së bashku përvojën (të dhënat), analizën mbi këto, rrugëzgjdhjet e problemeve, dhe të mbushin me propozime atdheun, t’i japin zemër popullit shqiptar në Shqipëri e në troje të tjera etnike.

Asgjë prej këtyre nuk kishte në fjalimin e Edi Ramës. Naim Frashëri do të thoshte:

*“Oh sa qenë të munduar,
Ata që vuan për botë,
Turp të math kanë rrefyerë,
Punuanë fare kot”*

Dy janë rrugët që mund të punojnë dikush, ose për kombin e vet, ose për të huajtë. Qartësisht fjalimet në diasporë janë ato që tregojnë se Edi Rama dhe Partia Socialiste janë në një udhë krejt antikombëtare dhe po sulmojnë aty ku nuk duhej, në diasporën shqiptare, ku kombi ka shpresën e vetme dhe përfundimtare. Kaq siguri fodulle e kanë fituar nga puna që bëjnë në Shqipëri. Por shumë shpejt do të kuptojnë shijen e hidhur të asaj që e thotë Sami Frashëri:

“Opinion publik, edhe pse, në pamje të parë mund të duket i dobët, në të vërtetë, është shumë më i fortë nga sa duket, dhe është i aftë të shkatërrojë çdo forcë materiale”

Krenarinë e Shqipërisë e përdor në atë mënyrë që të indikutojë si prapamendim edhe mendimin “Kemi bërë dhe do të bëjmë edhe pa ju. Jemi të vetëmjaftueshëm. Nuk ua kemi nevojën”, që mund të jetë një dëm kolosal kombëtar. Kjo është arsyeja që e thotë me gjysmë zëri “po siç vijnë të tjerët të huajtë, ejani edhe ju”. Qartësisht ua ka frikën. Qartësisht synon t’i frikësojë, para se të frikësohet vetë. Qartësisht i shet në shtetet e huaja që kanë interesa në asimilimin e diasporës, në dobësimin afatgjatë të Shqipërisë. Krenaria e tyre kombëtare, do të zbriste disa hapa poshtë nëse diaspora shqiptare do të kthehej në atdhe, sepse ata do të ishin në gjendje ta ndryshonin rrënjësisht situatën në pesë vjet.

Edi Rama qëllimisht nuk e preku vetëdijen kombëtare dhe objektivat apo sjellje kombëtare të diasporës. Ai qëllimisht dha modelin e “asimiluara” të diasporës, ato që punuan për Greqinë dhe Italinë, por nuk dha si shembull diasporën patriotike shqiptare të shekullit 19 dhe fillim shekullit 20, si diaspora e Stambollit, e

Bukureshtit, Sofjes, SHBA-së, të Egjiptit etj. që realizoi Lëvizjen e Rilindjes Kombëtare. Përkundrazi në Greqi i quajti idhtarët e tyre (pra të frymëzuarit na ky model), “fosile të gjalla të shekullit 19”. Merrni me mend që i gjithë sistemi arsimor shqiptar është duke prodhuar (pavarësisht se jo aq mirë) të tilla fosile. Kjo është arsyeja që ne vazhdimisht po e theksojmë që Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar në luftën ndaj Rilindjes Kombëtare dhe këtë po bën me metoda finoke, nën rrogë, duke hequr “Mësonjëtorën e parë shqipe” në Korçë, duke hequr statusin Muze Kombëtar të Arsimit, duke dhënë për përpunim propagandistik konceptin “Besa” tek Muzeu Hebraik në Tiranë, duke hequr fjalën “kombëtare” nga tofgjalëshi “Rilindje Kombëtare”, duke sulmuar Vëllezërit Frashëri, duke përdhunuar varrin e Mithat Frashërit etj.etj.etj.

Ambasadat tona në botë i kanë patur arsyetimet tona mbi *kompetencën globale* të cilat mbështeten në një ekspertizë e reflektim mbi arritjet më të mira në fushën e shkencave të edukimit global, ku “Udha e shkronjave” ka patur fatin të jetë në grupin e shkollave pararojë në botë, në atë grup që Cambridge International Education, në 2016-2018 e caktoi të jetë shkollë pilot për Global Perspectives, që pati një pilotim botëror në 25 shkolla fillimisht. Këto arsytetime të bëra në librin (broshurë) Global Albania synonin ndihmën në konceptimin e punës me diasporën. Ambasadat tregojnë se udhëzohen të tregojnë qëllimisht një indiferencë ndaj mesazheve tona që është për ne me mesazhin “mos u merr me këtë punë” (ka kush mendon për to). Të tillë indiferencë ato treguan edhe kur u dërguam Programin Edukativ të Shkollave Shqipe, një artikull i të cilit ishte “Programi i kthimit në atdhe”.

Po sa shqiptarëve të tjerë ua japin ata këtë mesazh? Të gjithëve dhe këtë e tregon vetë Fjalimi i Edi Ramës që qartë i lë të kuptohet diasporës “*Mos u merrni me punë kombëtare, po shihni hallet tuaja. Kur nuk merrem unë që jam kryeministër me punë kombëtare shqiptare, por me skema të huaja për ju (që s’keni parë gjë akoma), ju nga do ta gjeni shembullin e ku do ta kërkonti mbështetjen?*”

Me mënyrën se si e paraqet argumentin në Greqi dhe në Itali Edi Rama tregon se nuk dëshiron që diaspora shqiptare të mendojë as “globalisht” as “kombëtarisht” por të kthehet në shërbëtorë të “shoqërisë së shtetit pritës” derisa të asimilohet plotësisht në të. Ai e braktis atë, braktis misionin e saj, braktis potencialin e saj si shpresa e vetme që i ka mbetur kombit shqiptar për të dalë nga qorrrokaku, njëlloj si një gjeolog që e di saktë se ka flori poshtë dhe thotë “këtu nuk ka gjë”. Këtë “dituri gënjeshtare” kërkon të instalojë me fjalimin e tij në diasporë, duke e lënë kom-

bin shqiptar të varfër në ide, të varfër në frymëzim, të varfër në shpresa, derisa t’i fusë pesimizmin e ta drejtojë kombin drejt shturjes, asimilimit, tjetërsimit, konvertimit, në atë mënyrë që Sami Frashëri e thotë me këto fjalë:

“Shturja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyeten.”

Edi Rama me mënyrën si vepron të paktën në këtë fjalim dhe në këtë tur me diasporën po e tregon veten si administruesi i kësaj shturjeje kombëtare që në radhë të parë është ideore.

Kryeministri nuk tregon asnjë ngazëllim nga bashkimet e shoqatave patriotike shqiptare, nuk gëzohet që ka shkolla shqipe dhe nuk referon asnjë sukses të tyre (që realisht ato e kanë qoftë edhe modest, por në çdo rast frymëzues). Ato nuk janë politike, janë patriotike, dhe logjikisht nuk duhej të kishte probleme me to, por në fakt me indiferencën e plotë ndaj tyre, ai i sulmon “tinëz”, sepse u sulmon misionin dhe vlerën, u sulmon raportin me misionin kombëtar. Me këtë synon të dekurajojë diasporën të vijojë të mbledhet rreth tyre. Me një farë të drejte ato mund të thonë “Përse vlen kjo puna jonë, kur shteti nuk na pyet, ose vazhdimisht bën aq punë sa të survejojë, por jo edhe realisht të ndihmojë e të marrim vlerë”.

Edi Rama kërkon një marrëdhënie individuale me shqiptarët. Kjo është tepër dëmtuese për formimin e një kombi. Kombet duhet të nderojnë organizimet lokale dhe t’i quajnë ato si njësi bazë që ruan dhe zhvillon me siguri identitetin, kulturën, gjuhën dhe interesin kombëtar.

Sami Frashëri thotë “Pa bashkim nuk ka opinion publik” dhe këtë devizë e dinë edhe ata që duan të kundërtën, pra që nuk duan një opinion publik, ndaj meqë “bashkimi” sjell “opinionin publik” të gjitha bateritë çohen tek “përçarja”.

Diaspora shqiptare përfaqëson rezervën energjitime të kombit shqiptar. Kur Shqipëria të jetë keq (dhe tashmë është keq sepse po i mbarojnë burimet njerëzore) do ta zgjasë dorën patjetër tek lëvizja e diasporës, por ama deri në atë kohë ajo Shqipëria duhet të kujdeset që ajo të mbetet shqiptare dhe mekanizmin e të mbeturit shqiptar, e ka dhënë Sami Frashëri dhe kjo duhej të ishte politikë shtetërore:

“S’mund të ketë Shqipëri pa shqiptar, s’mund të ketë Shqipëtar pa gjuhë shqip, s’mund të ketë gjuhë shqip pa shkronja shqipe, pa shkolla në të cilat mund të mësohetë shqipja”

Me mënyrën se si Partia Socialiste po i organizon këto veprimtari, po shërben si megafon gjigand që të përhapen më me forcë mesazhe dekurajimi të diasporës për t'u kthyer në atdhe, mesazhe se nuk ka asnjë interes shtetëror që të investohet në formimin kombëtar, në shqiptarizimin e fëmijëve të diasporës.

Interesi është që të nxitet shqiptari i diasporës të mendojë pak a shumë *“Derisa shteti shqiptar nuk ma ka kujdes kombëtarizimin e fëmijës sim, sepse qartësisht po e shoh që nuk e ka me qejf gjuhën dhe arsimin shqip, atëherë një orë e më parë t'i them fëmijës “asimilohu në kulturën e vendasve” e mos u tundo ta kthesh kokën pas drejt Shqipërisë, drejt gjuhës shqipe”*.

Natyrisht që kryeministri nuk është pa mend ta bëjë këtë “kaq qartë” por fjalimin e tij në Itali e kemi këtu të plotë 100% (të plotë kemi dhënë edhe fjalimin në Greqi) dhe lexuesi mund të gjykojë vetë nëse kam apo jo të drejtë të dal në konkluzionin se ideja kryesore e fjalimeve në diasporë është dekurajimi i diasporës për t'u kthyer në atdhe dhe nxitja e një asimilimi të shpejtë dhe përçarja.

Ka arsye të besojmë se duke vepruar në këtë formë, socialistët po e duan Shqipërinë për vete.

Veprimtaritë e Partisë Socialiste në diasporë janë veprimtari mësymëse në diasporë dhe ka shumë rëndësi mesazhet që japin. Një ditë para takimit në Milano, 25 maj 2024, botova artikullin “Ministria e jashtme injoron dhe përçan shkollat shqipe” për të analizuar dy postime “finoke” të Ministrisë së Jashtme.

Realisht mendova që artikujt e mi kritikë, që po i quaj pjesë e opinionit publik, të ndarë prej meje edhe me ambasadat shqiptare, pra nënkupto edhe me Qeverinë, edhe me Partinë Socialiste, mund të ndryshonin në ndonjë mënyrë qasjen e fjalimit të Edi Ramës në Itali (pas Greqisë), duke menduar që propaganda do të kishte nevojë për “gënjeshtër” edhe në atë drejtim ku kisha tërhequr vëmendjen, pra a) në dekurajimin e diasporës për t'u kthyer në atdhe dhe b) në nxitjen e asimilimit të diasporës, duke mos investuar në identitetin kombëtar të saj, investim që shprehet kryesisht me investime në fushën e gjuhës shqipe, të shkollave shqipe, të programeve mësimore, të botimeve të shumta dhe të vlerësimit të organizimeve patriotike apo c) në përçarjen e saj. Asnjë prej këtyre ndreqjeve nuk ndodhi në fjalimin e Edi Ramës nga Greqia në Itali, gjë që provon për fat të keq se politika e shpopullimit të Shqipërisë, i ndryshimit të natyrës etnike apo politike nuk është më një hipotezë, por e provuar plotësisht dhe provohet nga mesazhet që iu dhanë diasporës në të dy këto fjalime.

A mund të thotë Ministria e Jashtme që e ka për detyrë institucionale të sitë mendimin në diasporë se çfarë bën ajo me idetë dhe analizat që i vijnë prej nesh? Cila është procedura, protokollin se si ato e trajtojnë një artikull kritik? Si diskutohet? Si analizohet? Si i komunikohet shkruesit?

Përderisa ne ia nisim Ambasadave tona që formatohen nga Qeveria e Partisë Socialiste që ka pushtetin qartësisht nuk kemi asnjë dëshirë për përdorim politik dhe po shprehim dëshirën për bashkëpunim duke u mbështetur në përvojën tonë si shkollë shqiptare. A mund të thotë Ministria e Jashtme a ka ndonjë shkollë prej së cilës ajo merr të tilla analiza të hapura nga këndvështrimi i një shkolle që punon në lëmin e ideve? Me siguri jo!

DIASPORA MUND E DUHET TË KTHEHET NË ATDHE

Është plotësisht e mundur që diaspora të kthehet në Shqipëri, sepse shtëpitë janë bosh, bizneset janë pa fuqi punëtore, institucionet arsimore e akademike kanë nevojë, çdo sektor ka nevojë, çdo qytet e fshat ka nevojë, fiset kanë nevojë, komunitetet kanë nevojë. Atëherë për kë po “ruhet Shqipëria” përveçse për të huajt dhe për shërbëtorët e tyre socialistë, që nuk shohin që po u shuhet fisia, rraca dhe gjaku, por janë verbuar politikisht aq shumë sa duan më shumë “fitoren e propagandës” sesa kombin shqiptar, sesa fisin e tyre, e gjakun e tyre që po e shohin t'u shpërbëhet para syve.

Teknikat e fjalimit të Edi Ramës ngelën po ato që ishin në Greqi. Edi Rama dhe Partia Socialiste këmbëngulën në mesazhe që dekurajojnë kthimin në atdhe dhe nxitin asimilimin e plotë. Duke dekurajuar diasporën të kthehet në atdhe, Edi Rama ka inkurajuar popullin shqiptar të vijojë me shpërnguljen nga trojet etnike me ritme më të shpejta se deri tani.

Kombi shqiptar ka nevojë të dijë ose të monitorojë “kahun” e lëvizjes dhe me arsyetimin e tij Edi Rama u tregoi qartësisht se ky kah është nga “emigrimi” (më shumë të shkojnë sesa të vijnë).

Kjo do të thotë se ai e do Shqipërinë ose për të huajtë ose për socialistët, ose për të nënshtruarit (shërbëtorët) e tyre. Në këtë kuptim i bie që socialistët (e dimë që jo të gjithë) janë dakort të përzënë kë munden nga Shqipëria dhe të bashkëjetojnë me të huajt që do të zgjedhin vetë dhe që për çastin quhen “turistë”, por do të shohim se shumë nga “këta turistë” do të jenë blerës të prenotuar më parë që “marrosen” pas Shqipërisë, në fakt kanë qenë në plan për të ardhur vetëm për të ndryshuar strukturën etnike.

Biznesi i kthimit familjar, fisnor, krahinor të diasporës në atdhe është një biznes jashtëzakonisht delikat dhe mjaft i ndjeshëm edhe ndaj mesazheve, ndaj fjalimi i Edi Ramës me megafonët e sallave të mëdha dhe të vëmendjes mediatike të madhe, është një grusht i fuqishëm në barkun e kombit dhe nuk mund të merret thjesht si një “fjalim” dhe kaq. Dëmi është kryer jo pak.

Përmes ambasadave dhe konsullatave, Partia Socialiste ka investuar në diasporë që ajo të ngrëjë jo struktura vërtetë patriotike dhe dhe të depolitizuara, por strukturat socialiste të kamufluara nën “petkun kombëtar” duke shfrytëzuar tolerancën e natyrshme kombëtare, duke i gënjyer komunitetet shqiptare që këto janë vetëm për gjuhën shqipe, ndërkohë që në Milano i pamë drejtuesit e disa prej “organizatave patriotike” apo “shkolla shqipe” të rreshtuara pranë Partisë Socialiste të ftonin anëtarët apo prindërit e tyre të shkonin në mitingun e Partisë Socialiste, me pretekstin “Atdheu na thërret” (kur në fakt ishte PS-ja na pret), duke përfitur nga një poster që ishte pa logon e PS-së.

Kjo do të thotë që Partia Socialiste po organizon diasporën me kushtin që nëse do të ketë kthim në Atdhe kjo t’u ofrohet vetëm atyre që do të rreshtohen me socialistët dhe do t’u bëhet “vetingu” nëpër “organizatat në dukje patriotike”, që “fryhen” edhe më shumë prej “aksesit të preferuar në konsullatat tona” që bëjnë sikur nuk shohin “të tjerët”.

Të gjithë të tjerëve do t’u nxirren probleme nga ambasadat tona, do t’u dekurajohet pjesëmarrja në kurset e gjuhës shqipe, nëse nuk rreshtohen në shkollat shqipe që janë të Partisë Socialiste.

Artikulli i parë që botuam kur morëm vesh aksionin e PS-së në diasporë kishte titullin “Politizimi i diasporës: lajmi më i keq”.

Ja ku e gjejmë veten të bëjmë artikuj të tillë që qartësisht reflektojnë përçarjen.

Megjithë që përgjegjësitë për mesazhet që thonë janë të vetë organizatorëve shqiptarë, në këtë rast Edi Rama dhe Partia Socialiste, ka arsye që opinionin publik shqiptar të monitorojë sjelljen e qeverive të Greqisë, të Italisë, të Gjermanisë dhe të Britanisë së Madhe lejojnë në territorin e tyre të zhvillohen me pompozitet “veprimtari të tilla të veçanta” qartësisht kundër identitetit dhe interesit kombëtar të diasporës shqiptare, mesazhe për asimilim të shpejtë dhe dekurajim të kthimit në atdhe. E dimë që është në interesin e tyre që diasporat të asimilohet sa më shpejt në shtetet e tyre dhe të mos mundet të rikthehet përfundimisht në vendin e origjinës. Sidoqoftë prenotimi i veprimtarive të tilla me mesazhe asimilimi tek Qeveria Shqiptare është diçka e rrallë në këtë botë dhe duhet të ketë si kundërvleftë një mbështetje poli-

tike që mund të llogaritet si “antikombëtare” në thelb, përderisa kostot kombi i paguan me një dëmtrim të cilësisë kombëtare të diasporës së vet.

Fryma e kombeve nuk duhet të jetë e tillë. Njerëzit duhet të kenë të drejtën reale të kthehen në atdhe dhe të mos asimilohen. Në këtë rast “paradoksi” është që këtë asimilim e nxit kryetari i shtetit “amë”, por qartësisht në interes të shteteve pritëse që bëjnë sikur janë “indiferente”.

Të gjitha këto qeveri duhet të zbatojnë ligjin e tyre kombëtar e të shohin nëse Partia Socialiste e Shqipërisë ka shfrytëzuar apo jo statusin e shoqatave që janë regjistruar si “jopolitike” për të fshehur “natyrën e tyre politike”.

Shqipëria dhe kombi shqiptar është vërtetë në udhëkryq me këtë sulm të veçantë e të paparë në diasporë, ku vetë shteti ha kombin e vet. Diaspora shqiptare po dëmtohet aty ku ajo duhej të ishte e mbrojtur nga fryma demokratike dhe e kartës së kombeve të bashkuara nga qeveritë e Greqisë, të Italisë, të Gjermanisë dhe të Britanisë së Madhe!

Ne nuk kemi asgjë me degët e deklaruara të Partisë Socialiste, por kemi shumë problem me të gjitha ato shoqata që i shiten komunitetit “si patriotike” dhe në fakt janë thjesht “politike”, pra të njëanshme. Mund të jenë edhe patriotike edhe socialiste, por duhet ta deklarojnë këtë natyrë.

Fjalimin e Edi Ramës në këtë artikulli do ta gjeni 100% të cituar, me synimin që të mbrohet lexuesi në gjykimin e vet të pavarur. Ka një dallim të qartë ndërmjet Citimit dhe Komentit.

POZICIONI YNË ËSHTË KËNDVËSHTRIM SHKOLLE DHE JO KËNDVËSHTRIM PARTIE POLITIKE

Sado kritik e oponent të jetë pozicioni ynë dhe këtu shpjegimet janë të mjaftueshme, ky qëndrim përsëri nuk duhet të klasifikohet sikur i përket opozitës. Shkolla është e depolitizuar dhe ne e respektojmë këtë, edhe pse ky qëndrim është tepër kritik ndaj qeverisë, kryeministrit dhe Partisë Socialiste. Arsyeja që shkruajmë është që ne nuk kuptojmë me “depolitizim” edhe “shkombëtarizimin” e shkollave apo “heqjen e trurit të shkollave” apo paralizimit të tyre për të dhënë mendime për kombin e vet. Mendojmë që u bëjmë mirë shkollave dhe jetës shoqërore shqiptare t’i japim një nxitje për të folur e për t’u shprehur.

TIRANË, MË 29 MAJ 2024

ANILIZË E FJALIMIT TË PLOTË TË EDI RAMËS NË ITALI

CITIM: *Të dashur vëllezër e motra shqiptarë, të Italisë. Jam thellësisht i prekur nga mikëpritja juaj. Dua që ta dini që më ka emocionuar tej mase vala e nxehtë e përshëndetjeve dhe ftesave të shumë shqiptarëve që më kanë shkruar gjithë këto ditë, menjëherë pasi mbaroi takimi në Athinë, për t'i vizituar atje ku janë në të katër anët e Italisë. Shumë faleminderit të gjithëve.*

KOMENT: Më saktë do të ishte të thoshte “motra e vëllezër socialistë”. Klasifikimi i saktë i takimit është organizim i Partisë Socialiste. Fshehja e logos së Partisë Socialiste është pjesë e propagandës “takim me shqiptarët e diasporës” por edhe e taktikës që shoqatat me mbulesë “patriotike” dhe shkollat me mbulesë “shqipe” që janë leva të Partisë Socialiste t’i shpëtojnë “filtrit politik” të gjykimit të veprimtarive të tyre nga ana e organeve të shtetit italian apo grek që shqyrtojnë realitetin e veprimtarisë së shoqatave që në statute kanë deklaruar se nuk do të jenë politike. Në bazë të ligjit italian (por edhe një praktikë e gjerë në shtete demokratike) shoqatat nuk e kanë të lejuar të marrin pjesë në veprimtari politike, përderisa në statut e akt themelimi janë deklaruar si “jopolitike”.

CITIM: *Plot prej atyre që më kanë shkruar me siguri janë edhe këtu, por shumë, por shumë faleminderit për praninë tuaj, por shumë e shumë të tjerë janë larg në qytete, në qyteza të tjera të këtij vendi mik. Mirënjohje pa fund për dëshirën e madhe për të më takuar dhe një përqaqim të gjithëve kudo ku janë nga kjo arenë e mrekullueshme ku flamuri kuqezi dhe tringjyrëshi italian dëshmojnë megjithë bukurinë e thjeshtësisë lidhjen e përjetshme mes dy popujsh të cilët në dhjetra shekuj i ka bashkuar një det i tërë historie në këtë pellg të Mesdheut ku edhe është ngjizur edhe shpirti i Europës së sotme.*

KOMENT: Këtej e tutje do të fillojmë ta monitorojmë “shpirtin e Europës së sotme” si një koncept që kërkon të përthithë “identitetin kombëtar” të diasporës shqiptare dhe bashkë me të çorientimin e udhës që duhet të ndjekë diaspora shqiptare, që sipas Edi

Ramës, thjesht duhet të investojë në harresën e gjuhës, të kulturës dhe të objektivave kombëtarë shqiptarë. Edi Rama nuk deklaroi asnjë objektiv kombëtar kombëtar.

CITIM: Ju, shqiptarët e Italisë, jeni shembëlltyra më rrezatuese e pararojave shqiptare të ribashkimit me Europën. Ju, jo politika, jo media, as biznesi jeni (ovacione) përbashkuesit më kryesorë të dy brigjeve të Adriatikut në një hapësirë marrëdhëniesh të gjithanshme. Ju jeni fuqia më e madhe e rikthimit të Arbërisë së vjetër dhe të Shqipërisë së re në shtratin natyral të qytetërimit European. Ju, emigrantët e djeshëm shqiptarë dhe qytetarët e barabartë të Europës së sotme jeni krenaria shqiptare e mishëruar në një sukses frymëzues për misionin tonë kombëtar të bashkimit përfundimtar me Europën demokratike. (ovacione) Faleminderit! Faleminderit! Sot kjo duket gjëja më e natyrshme në botë por dje kjo dukej gjëja më e pamundur në botë, kur ju bëtë mbartësit e fillesës tronditëse të këtij misioni historik mbi anijet e ndryshkura të Shqipërisë komuniste, ku, siç do ta thoshte, po t’u kishte parë udhëtari dhe historiani i shek 19 Jakov Filip Follmerajër “Formësuar një trup si të gjigandëve shqiptarë që prej pesëqind vjetësh dergjeshin mes maleve”

KOMENT: Tezën kryesore e fjalimit është pikërisht në këtë paragraf. Në mënyrë fyese për logjikën, Edi Rama shpall pa asnjë referencë “misionin e ribashkimit me Evropën” si mision të diasporës në Itali. Ashtu si tjetëron historinë brenda Shqipërisë kërkon të tjetërsojë edhe të vërtetën dhe arsyetimin e diasporës shqiptare dhe t’u japë atyre një objektiv jo real, por gati donkishotesk të luftojnë “fiktivisht” (me mullinjte e erës) për të qenë pjesë e misionit të ribashkimit me Evropën. Edi Rama tjetëron të vërtetën kur i jep një “pamje të qëllim të kolektive kombëtare” lëvizjes së diasporës kur është thjesht “realizim individual” pavarësisht se masiv dhe paradoksalisht u jep objektiva “europianë” dhe nuk u jep ndonjë motiv “italo-shqiptar”, ta zemë ndreqjen e marrëdhëniesh Shqipëri - Itali. Kësaj i shpëton sepse do të vihej nën sulmin e mediave italiane, por “mediat italiane” nuk kanë

asnjë punë me deklaratat e një kryetari shteti që synon të hutojë diasporën e vet.

Një diasporë ose është e përçarë ose është e bashkuar dhe nëse është e bashkuar ajo lëviz me qendër nga atdheu dhe fryma kombëtare. Për objektivat e tjerë, ajo lëviz sëbashku me shtetin ku jeton. Për t'iu shmangur referimit kombëtar Edi Rama shpik “shpirtin e Europës” dhe “misionin e bashkimit me Evropën”. Po diaspora shqiptare që kanë shkuar në SHBA, Zelandë të Re, Afrikë, Dubai, çfarë misioni “bashkimi” po bëjnë? Kjo shërben qartësisht që ai t'iu shmangët “diasporës shqiptare” si një trup i vetëm kombëtar. Unë e kam bërë këtë në konceptin “Global Albania”, pra e kam trajtuar atë si një trupë të vetme kombëtare. Do të shohim që Edi Rama edhe në Greqi edhe në Itali flet sikur ka të bëjë me “pjesë këmbimi” që janë të ndryshme nga natyra. Nuk sheh të njëjtën cilësi kombëtare tek shqiptarët.

Nuk ka aspak kuptim që të bësh “artifice” të tilla zbukuruese. Njerëzit vajtën në Itali, siç kanë shkuar emigracioni ynë në Jugosllave, apo Greqi, pikërisht se nga këto shtete rrethohemi dhe, kur kanë ikur, nuk kanë marrë aspak ndonjë mision të qëllimtë kolektiv, pra nuk kanë pasur aspak një “mision bashkimi me Evropën”. Nëse tani njohuritë e tyre, pozicioni i tyre mund të shfrytëzohet për ndonjë përfitim të Shqipërisë, kjo duhet analizuar. Por qëllimi është që t'ua largojë sa më shumë mendjen nga “programi i kthimit në atdhe” ndaj shpik “misionin e ribashkimit me Evropën” duke i çorientuar plotësisht. Mision kanë patur të shpëtojnë veten dhe familjen e tyre dhe këtë e kanë arritur. Këtu ata janë të barabartë me çdo emigrant të çdo kombi.

Ndryshim do të bënte nëse shteti shqiptar pas kësaj humbjeje të madhe njerëzore, rrjedhje masive gjaku shqiptar, të kujtohej dhe ta ndreqte përmes politikës dhe programit për kthim të emigrantëve shqiptarë. Provohet se Edi Rama si në Greqi dhe në Itali e shfrytëzoi fjalimin për të dekurajuar kthimin dhe për t'iu asimiluar.

Synon një çorientim e topitje totale të trurit të diasporës, kur ai thotë “*Ju jeni fuqia më e madhe e rikthimit të Arbërisë së vjetër dhe të Shqipërisë së re në shtratin natyral të qytetërimit Europian.*” Qartësisht u vë brirët diasporës.

Zbukuron statusin e tyre, kur në fakt, ata janë me problemin e humbjes të atdheut, me humbje të shtetit, me humbje të identitetit. Ndërkohë thotë: “*Ju, emigrantët e djeshëm shqiptarë dhe qytetarët e barabartë të Europës së sotme jeni krenaria shqiptare*

e mishëruar në një sukses frymëzues për misionin tonë kombëtar të bashkimit përfundimtar me Europën demokratike.” (ovacione) *Faleminderit! Faleminderit!*

Salla që bën ovacione qartësisht nuk kupton se çfarë thuhet, por kupton që nga ambalazhi (sintaksa) mbase ky është çasti që duhet duartrokatur.

Elozhet budallepsëse të diasporës nuk kanë të sosur kur thotë “*ju bëtë mbartësit e fillesës tronditëse të këtij misioni historik mbi anijet e ndryshkura të Shqipërisë komuniste, ku, siç do ta thoshte, po t'ua kishte parë udhëtari dhe historiani i shek 19 Jakov Filip Follmerajër “Formësuat një trup si të gjigandëve shqiptarë që prej pesëqind vjetësh dergjeshin mes maleve”.*

“E STATO UN ALBANESE” DIKOTOMI E QËLLIMTË, KRIJIM I PSIKOKOZËS SË RREME

Edi Rama e bëri edhe në Greqi dhe po e bën edhe me Italinë. Për t'iu dukur se po merr në mbrojtje, ka nevojë për një “fabul” dhe e gjen këtë tek “fyerja nacionale” që paska ndodhur. Sigurisht që ka ndodhur, por nuk ka qenë e vetmja qasje ndaj shqiptarëve dhe nuk ka asnjë leverdi praktike, kur sipas mendimit të vetë Edi Ramës situata tani qenka përmirësuar. Ky teprim bëhet i qëllimtë, për të treguar se paska ndodhur një “ndryshim kolosal”. Në të vërtetë nuk ka ndodhur asnjë ndryshim: “*erdhën nga një adhe me shthurje shteti*” dhe përsëri “*kanë një atdhe që dekurajon kthimin dhe nxit asimilimin*”. Për të shmangur këtë lloj arsjetimi, ka nevojë të shpikë “*E stato unë albanese*” për të treguar se ato që do të thotë këtu nuk janë, siç janë realisht interes thelbësor i vetë Qeverisë Italiane, që kërkon që diaspora shqiptare të mos lëvizë nga Italia. Në Greqi tha “*Përjetuat poshtërimin e fshesave të zeza të fund shekullit 20, kur ju shkullnin nga shtëpitë, me rrobat e trupit nëpër natë për t'iu deportuar në Shqipëri*”. Evokon ndjesitë e këqia që shoqëruan kohët e emigrimit masiv për të ardhur në çastin ku “asimilimi” dhe “humbja e atdheut” do të shihet si triumf.

CITIM: “*E stato un albanese*” – me siguri të gjithë ata që e kanë shkellur Italinë në vitet 90 e kujtojnë këtë zile alarmi. “*E stato un albanese*” ishte avazi që shponte veshin kur dëgjohej, qërronte syrin kur lexohej, krruste shpirtin dhe ulte kokën e shqiptarëve në çdo mjedis kur shqiptari duhej jo thjesht ta fshihte por mundësisht ta harronte fare të qenët shqiptar për t'iu pranuar si njeri i zakonshëm dhe kur njeriu

i zakonshëm shqiptari në kërkim të jete të re përmes një pune të ndershme ndjehej si një person në kërkim për fajin e vetëm që ishte një “un albanese” (ovacione). Përplaseshin dy makina, gazetata shkruanin “E stato un albanese”. Nododhte një grabitje telegazetat lokale informonin “E stato un albanese”. Kryhej një vrasje telegazetat kombëtare filloi me lajmin “E stato un albanese”. E kam dëgjuar me veshët e mi kur Telegiornale raportonte nga vendngjarja e një krimi. Gazetari me mikrofon në dorë dhe me dritat e makinave të policisë që rrotulloheshin në sfondin e natës raportoi “L’assassino e scappato e non e stato identificato me c’è la quasi certezza delle forze dell’ordine che e stato un albanese”. Edhe kur ikte të paditur vrasësi i panjohur ishte un albanese. Ky ishte shqiptari në pasqyrat italiane të atyre viteve, kur ne u shfaqëm në dylbitë e Italisë si një jashtënxjerrje e errësirës së funddetit zhveshur nga gjithçka tjetër përveç ëndrrës së një parajse lirie e cila na nxirrte lart mbi ujë, gjysmë të vdekur, me forcën e papërmbajtshme të një imagjinatës së ushquar me vite të tëra nga valët e televizioneve italiane. Asokohe, italianët nuk ishin fare si ta dinin që përpara se të preknin brigjet e Italisë shqiptarëve u jehonte shpirti nga libertaja dhe felicitaja e Albanos dhe e Rominës, u buçiste gjoksi nga zhurma e ardhur deri në shtëpitë e tyre prej stadiumeve të Serias A dhe u dukej se edhe kupën e botës së 82 e kishin edhe ata pjesë të tyre. U ishte bërë mendja si një magazinë sendesh të vjedhura nga valët e paligjshme të programeve televizive italiane ku kishin çdo album të Çelentanos, çdo trofe të Sanremos, çdo reklamë të Karuselos, çdo fustan të Rafaelës, çdo personazh të telenovelave të Rait apo Mediasetit, fal sa e sa inkursionesh nëpër natë nëpër ballkona e tarraca për të kthyer antenat nga perëndimi, njësoj siç Ushtria Popullore kthente kundërajrorët në pritje të avionëve anglo-amerikanë.

KOMENT: Pikërisht sot gazeta proqeveritare “TEMA” raporton nga Anglia: “Gazetat citojnë gjithashtu se të dhënat tregojnë se shqiptarët janë kombësia më e madhe e huaj në burgjet e Mbretërisë së Bashkuar.” Një status të tillë të ulët “C’è stato un albanese” nuk qenka vetëm e 30 vjetëve më parë, por edhe sot dhe me vulën e drejtësisë. Po ashtu në Zvicër, numri i shqiptarëve të burgosur me origjinë nga Shqipëria është disa herë më i madh se i shqiptarëve nga Kosova. Çfarë ka për të thënë për këto num-

ra? Kush e jep këtë edukatë përveçse mënyra si funksionon shteti dhe shoqëria në Shqipëria? Burgjet nuk janë mbushur vetëm vitet e para, por vijojnë të mbushen edhe tani. Paralel me ta janë edhe shqiptarët korrektë dhe të edukuar, por ata janë produkt i traditave familjare, fisnore, krahinore e kombëtare që sigurisht po vijnë në shturje, por shturja ka ritmin e vet. Është një çoroditje e qëllimshme, siç e thamë më lart. Qartësisht tjetërsohet situata derisa t’i afrohet provës se ajo që ka bërë çdo emigrant individualisht nuk paska qenë diçka individuale, një mundim individual, por kjo paska qenë një “mundim e objektiv kombëtar” dhe jo thjesht individual, pavarësisht se i përsëritur. Edi Rama kërkon të bëjë psikologun, por edhe këtë nuk e bën, sepse anashkalon rëndë shkaku e tronditjes shpirtërore të diasporës që ka një dhe vetëm një emër “humbje e atdheut” dhe ka një dhe vetëm një kërkesë “A më do Shqipëria të kthehem? A do të kujdeset shteti shqiptar nëse unë vendos të kthehem? Cili është programi?” Këto i shmang në dhe merret qëllimisht me devijimin e problemit aty ku nuk është.

CITIM: Italianët nuk e kishin fare idenë se përtej asaj që dukej, asaj **jashtënxjerrje njerëzore** nga **humnera e ferrit dantesk** të komunizmit matanë Adriatikut dhe pamjes së albanezëve që papritur filluan të shfaqen nëpër rrugët e Italisë, si ata **figurantët e filmave nga mesjeta**, duke ecur **si të goditur mbrapa kokës** dhe duke përsëritur “amico” “amico”, kudo ku mbanin hapin, **fshihej një shpirt i marrosur më italian se italianit më të flaktë**, (ovacion) një **adhurim deri në vetmohim i një Italie** që në mendjen e shqiptarëve kishte marrë **pamjen e një toke të shenjtë ku gjendej parajsa e kësaj bote**, një **dashuri e verbër pa kushte** e cila **nuk i linte gjë mangut të gjitha dashurive më të mëdha platonike**, por fatkeqësia e madhe ishte se, në të njëjtën kohë, Shqipëria, në sytë e Italisë, dukej si një ekran televizori kur ikin dritat: e zezë, e palexueshme, e rrethuar nga errësira e një gjysmë shekulli, qysh kur italianët e fundit e kishin parë, atëherë kur humbën luftën pushtuese dhe shqiptarët i morën nëpër shtëpi, i fshehën nga nazistët, i ushqyen dhe i trajtuan si familjarët e tyre, derisa i përcollën për në atdhe (duartrokitje).

KOMENT: Sulm frontal psikologjik ndaj së shkuarës së çdo individi, me pak fjalë “të mos u marrë malli prej nga vini” se kjo është situata “prej nga vini”. Qëllimisht ngushton konceptin për

atdheun dhe dashurinë për të, për gjuhën amtare shqipe, për fisin, për gjakun, që nuk ka lidhje fare me vitin 1990, por janë tepër të thella. Ai kërkon t'i fshijë ato me një paraqitje “mentale” dhe “momentin” ta përgjithësojë si “e gjithë e shkuara”, “i gjithë atdheu”. Nuk synon mallin. Sikur ta kishte seriozisht e pastërtisht do t'i kujtonte mallin diasporën dhe do të përdorte të gjithë arsenalin kulturor për t'i bërë të vlin për të atdhe. Ai bën krejt të kundërtën dhe kjo është thjesht kundër interesit kombëtar.

Po ia kujtojmë se çfarë mund t'u thoshte. Nga Lasgush Poradeci, :

Sa më pak e shëmbëllen:

Aq më shumë-e ndjek dëshira...

Pa nga malli që s'e gjen,

Dridhet gjithë hapësira.

Kjo është arsyeja që në mungesë të një referimi të tillë ndaj Frymës së Kombit, për ne të detyrueshëm në komunikimin me diasporën, kemi nxjerrë në krye të broshurës poezi e mesazhe nga Naim Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Fan Noli, Çajupi, De Rada, Ali Asllani, Bilal Xhaferr, Koliqi, Mitrush Kuteli që do të ishin të përshtatshme dhe një tërheqje nga Shqipëria.

CITIM: Në sytë e italianëve të viteve 90 asgjë nuk e lidhte Shqipërinë e paraluftës, provincën e dikurshme të Italisë, kujtimi i të cilës ishte flakur në mbeturinat e historisë italiane të fashizmit me Shqipërinë komuniste, që pikërisht nga ajo e kaluar ishte mbarsur si pjella imponuar e një shtatëzanie të mbrapshtë. E kush nuk i kujton ato kohë me damkën “E stato un albanese” kur zienin debatet në kanalet politike italiane. Ishte koha e një farë Umberto Bosi një tip që bëri thirrje që shqiptarët të vriteshin në det me pushkët e ushtrisë, një personazh që dukej (ovacione) sikur kishte dalë nga filmat komikë, i cili këtej bëri çorap, andej shkoi i bleu djalit diplomën tek një nga ato universitetet “Kristal” dhe “Vitrina” të Saliut II. Ishte koha kur gjiri i Vlorës ishte bërë si parkimi i garave ujore të shpejtësisë për skafet që turrehin për natë në errësirën e Kanalit të Otrantos ku të gjithë shihnin vdekjen me sy. Disa vdekja i merrte përgjithnjë në fundin e detit dhe të tjerët ia merrnin vdekjes në një kthesë të paimagjinueshme dhe fitonin lirinë duke prekur më në fund bregun e ëndrrës së tyre (ovacione). Ishte koha e mbyqjes së të Katërtit të Radës, **anijes që u bë simboli i luftës së shqiptarëve për t'u rikthyer në gjirin e Europës**

pas një shkulje me dhunë prej saj të një errësire të pafundme, jashtë librit të historisë europiane të pasLuftës së dytë botëror.

KOMENT: Plotësisht shpërdorim i qëllimshëm i kohës dhe tërheqje e vëmendjes drejt tematikave “të vdekura” dhe pa ndonjë vlerë reale për diasporën që është futur në një mësim historie me komente. Nëse më parë ikin me “skafe”, tani ikin me avionë dhe nuk kthehen më. Rezultati për kombin është po ai. Shpopullimi. Nuk ka asnjë mision rikthimi në gjirin e Europës përmes emigracionit. Është shpikje e propagandës për t'i dhënë “qëllim” një veprimtarie të paqëllimtë. Pak a shumë si në humorin e Shkodrës, kur i thonë njërit “*ke fut në burg gjysmën e Shkodrës*” edhe ky i kthehet “*kjo më vjen inat: të tërë kanë marrë paret e persekucionit dhe asnjë nuk ma ka qit një kafe*”. Synimi i emigrantëve ishte siguria familjare, siguria e jetës, siguria që do të kenë të nesërmen të hanë, të vishen, të mbrohen dhe ndaj ikën në emigracion. Edi Rama u vu “vulën” me hekur të nxehtë “*jeni nisur për misionin e rikthimit në gjirin e Europës*”, “*jeni pararojë e ribashkimit të Shqipërisë me Europën*”.

Në gjirin e Evropës, si koncept, nuk kthehet individi, por politika shtetërore dhe shoqëria në përgjithësi, standardet e saj dhe jo “individët”. Nuk ka ndonjë mision të Shqipërisë që realizohet përmes “emigracionit” që është një vendim individual për të ikur nga pamundësia e Shqipërisë për t'i mbajtur.

CITIM: Por Italia e kohës, fatmirësisht, nuk ishte Greqia e asaj e kohe. Jo vetëm populli italian, njësoj si populli grek, ua hapi derën bujarisht shqiptarëve duke i ndihmuar të ngriheshin mbi këmbët e tyre, por edhe qeveritë italiane, megjithëse tejet të trembura nga fenomeni i saposhaqur i imigrimit masiv drejt brigjeve të Italisë u sollën me Shqipërinë si askush tjetër.

KOMENT: Edi Rama duket sikur po u jep mësim emigrantëve, në të vërtetë po e shfrytëzon kohën për të përdorur emigrantët që t'u flasë qeverive të shteteve se çfarë “propagande” do t'u bëjë kombit shqiptar nëse ato mbështesin udhëheqjen e tij.

CITIM: Motra dhe vëllezër, ju thashë që mora shumë mesazhe nga shqiptarët e Italisë pas asaj valleje kuqezi në zemër të Greqisë. (ovacione) Më bëri përshtypje në më

shumë se një rast. Dërguesit nga Italia më thoshin që kur të vija në Milano nuk duhet të harroja që edhe ju keni vuajtur gati – gati sikur ndjeheshit të përjashtuar nga një garë dhimbjesh historike, pothuajse xhelozë për faktin se vuajtjet e tmerrshme të shqiptarëve të Greqisë e bëjnë më heroike nga tëra tjerat historinë e stërmundimshe të afrimit të shqiptarëve me Europën dhe të afirmimit të tyre si qytetarë europianë.

KOMENT: Qartësisht “propagandë” e rreme. Merrni me mend një emigrant që nuk ka punë tjetër, por në emër të të gjithë emigrantëve, në stilin përgjithësues (induktiv) të Edi Ramës dhe në shinat e shtruar prej tij në Greqi nuk paska punë tjetër veç t’i shkruajë kryeministrit “*kujto edhe vuajtjet tona*” (meqë të duhet në fjalimin e Milanos për t’iu shmangur detyrimit kryesor shtetëror për “*kthimin e emigrantëve në atdhe*” dhe për “*investimin në gjuhën, kulturën dhe identitetin shqiptar*”). Në udhë e sipër, kur vëmendja e dëgjuesit ka rënë poshtë nga fjalitë e gjata dhe në fund të një periudhe të gjatë, Edi Rama bën “transplantin e gënjeshtërs”. Vini re edhe një herë strukturën sintaksore:

“*vuajtjet e tmerrshme të shqiptarëve të Greqisë e bëjnë më heroike nga tëra tjerat historinë e stërmundimshe të afrimit të shqiptarëve me Europën dhe të afirmimit të tyre si qytetarë europianë.*”

Devijon faktin që mundimet e tyre nuk janë stërmundime të afrimit të shqiptarëve me Europën, por janë stërmundime të mbijetesës si individë, për bukë, veshje, strehim, para. Kush pati mundësi iku në SHBA që nuk është Europë, iku në Australi që nuk ishte Evropë. Devijimi i arsytimit është thjesht “shtrembërim i të vërtetës” dhe të quhet se po shkonin në Greqi e Itali për “politikë” dhe jo thjesht se nuk kishin mundësi të rrinin në Atdhe. Këtë e bën qëllimisht për “*të idilizuar largimin nga Atdheu*” dhe për t’i shtruar udhën “konvertimit të identitetit” të emigrantit dhe t’ia kundërvënë Europën Shqipërisë, pra “*Ju, emigrantë, keni arritur më shumë sesa atdheu, sepse keni arritur Europën.*”, pra jeni “*pararobjë*” dhe ne të gjithë “*do të vijmë pas jush*” “*do ta braktisim atdheun*”. Në fakt, është e kundërta: Edi Rama dhe socialistët që e ndihmojnë qartësisht (ky fjalim është provë) me politikën e tyre po detyrojnë të tjerë të ikin, me sa duket, për ta mbajtur Shqipërinë për vete me një strukturë etnike të ndryshuar. Është e rëndë ta thuash politikë antikombëtare, por nuk ka asnjë shteg tjetër nga ta çojmë logjikën, përveç se të gënjejmë veten. Mesazhet për diasporën do të jenë një “bumerang” për propagandën.

CITIM: Ndanin dhe ata në mesazhet e tyre histori të trishta, historia të pamundura *për t’u futur në tablonë e Europës*, të lirisë dhe të drejtave të njeriut. Janë histori që e kanë vendin në disa *pejzazhe tepër të zymta të shpirtit njerëzor. Nuk kanë lidhje me territoret e plagëve të mëdha nga luftrat e hapura* por me vuajtjet pa zë nga *konfliktet e fshehta të një kohe*, kur *traumat e përpjekjes për t’u përshtatur* e për t’u pranuar si të përshtatshëm quheshin thjesht domosdoshmëri të procesit të integritimit. Ai ishte një kohë kur *bashkimi demokratik europian* nuk ishte në gjendje as t’ia kërkonte dhe më t’ia vinte emrin e vërtetë projektit të përbashkët të Europës ku jetojmë sot. *Dhe ja si erdhi koha: ne shqiptarët jemi përgjegjës të barabartë të atij projekti jetik për të ardhmen e përbashkët të banorëve të këtij kontinenti në rrugën e fateve tona të pandashme europiane*, kur shtete e Europës demokratike o ia dalin të gjitha në krye së bashku si europianë pa dallim, o mbetemi mbrapa botës të gjithë bashkë, në një Europë që sot është e sfiduar si asnjëherë më parë qysh nga Lufta II Botërore. (ovacione)

KOMENT: Manipulim krejt i pastër, devijim i rëndë i analizës. Theksim i përsëritur me synim “transplantin e analizës”, “devijimin e orientimit”. Pra shqiptarët që iknin nga mungesa e kushteve elementare për jetesë, siç ikën nga atdheu çdo emigrant në këtë botë, paska ikur me planin “*e një projekti jetik për të ardhmen e përbashkët të banorëve të këtij kontinenti*”. Po të ishte salla e pakontrolluar nga “socialistët”, dikush do të dilte e të thoshte “*Ore ti! Na merr për budallenj, apo si?*”, por salla ishte konceptuar si një Megafon Gjigand. Qëllimisht këtu kam vendosur edhe ku saktësisht salla ka bërë ovacione. Salla ka durtrokitur pas këtij paragrafi krejt të zymtë, krejt gënjeshtar, krejt manipulativ. Edhe sot e kësaj dite, njerëzit nuk jetojnë aq shumë me objektivat shoqërorë, sa jetojnë me objektivat individualë dhe për këtë kujdeset pikërisht klasa politike. Në Shqipëri mungon opinioni publik, që do të thotë se njerëzit jetojnë të përçarë dhe ky difekt nga Shqipëria eksportohet edhe në diasporë. Shqiptarët e mësuar pa demokraci në Shqipëri e kanë të vështirë të mësohen me të në diasporë, sidomos kur bisedojnë me shqiptarë të tjerë.

Ndërkohë Edi Rama bën sikur shqiptarët i kanë në terezi të gjitha dhe e kanë mendjen të hapin “hartat” si në dhomën e Kryeministrit e të merren me “plane evropiane” dhe kur të kenë ndonjë paqartësi, t’i thonë kryeministrit “pa na sqaro pak në takimin e Milanos” se nuk po na dalin llogaritë e “ribashkimit me Evropën”.

CITIM: Gjermania e quajti “ribashkim” që në minutën e parë dhe ia doli në krye pa prituri dhe pa kërkuar që gjermanët lindorë të bëheshin të përshtatshëm në një proces të stërgjatur me kriteret standarde por edhe me lojra politike të diktuara nga zgjedhjet e radhës lart e poshtë në Europë. Ndërsa BE iu desh të zvarritej dhjetra vite me të ashtuquajturin zgjerim derisa carizmi rus u shfaq si ajo gjilpëra në sepetin e Kasheut të Pavdekshëm duke hapur luftën e parë pushtuese në këtë kontinent pas 77 vjetësh e duke e bërë Europën të fillojë të kuptojë më në fund se duhet të ribashkohet një orë e më parë, përmes urave të demokracisë, jo të zgjerohet me hapin e breshkës përmes kanaleve të burokracisë (ovacione).

KOMENT: Qëllimisht “vjedhje e kuvendit”, “vjedhje e kohës” për t’iu shmangur thelbit. Edi Rama shpërdoron kohën kombëtare me diasporën shqiptare. E lëmë mënjane se si u organizua takimi, se kush ishte në takim, dhe me çfarë teknikash Partia Socialiste dhe Qeveria e Saj, ambasadat e realizuan takimin. Takimi u bë, mediat ishin aty, njerëzit nuk ka më rëndësi se cilët ishin, megjithëse e dimë që ishin “një megafon gjigand”, një “thumb i ngulur në trutë e njerëzisë” (Migjeni). Tani ka rëndësi fjala që thuhet: A është apo jo ajo në nivelin e pritshmërive kombëtare dhe problematikës që haset në diasporë? Përgjigjia është qartësisht JO!. Një përfaqësues i diasporës shqiptare të Selanikut e tha në A2CNN që diaspora shqiptare në Greqi nuk është faktor politik, mund të jetë faktor në tregun e punës, por jo në politikë. Kjo është mëse e natyrshme. Shqiptarët e diasporës janë “jashtë atdheut” dhe ata janë të vetëdijshëm që nuk bëjnë e nuk duhet të bëjnë “komandë” në shtëpinë e tjetrit. Po të duan le ta bëjnë në shtëpinë e tyre, me kryeministrin e tyre. Edi Rama qëllimisht i shmanget edhe kësaj se e di që do të bjerë në “absurditet” dhe në vend që të thotë “faktorë të Greqisë, apo të Italisë” thotë “faktorë të Evropës”, ndërkohë që emigranti shqiptar nuk është faktor i Shqipërisë, nuk është as faktor i Greqisë, nuk është as faktor i Italisë, por ja që del kryeministri i tij “manipulator” dhe u jep një

“dekoratë më të lartë” atë të “faktorit të Evropës”. Kjo është një tallje e rëndë dhe në këtë tallje marrin pjesë në mënyrë të verbër sigurisht të gjitha strukturat e Partisë Socialiste.

CITIM: Ju, shqiptarët e Italisë, nuk i ndërruat emrat, forcërisht e gjerësisht siç u ndodhi tragjikisht qindra mijëra vëllezërve dhe motrave tona në Greqi për një arsye të vetme dhe të lemeritshme që e dimë shumë mirë që të gjithë dhe që do të mbetet një njollë turpi në historinë e Europës demokratike, por ama, nuk ishin të pakta rastet kur ju e morët përsipër vullnetarisht këtë ndryshim të identitetit që ajo zilja përndjekëse “E stato un albanese” mos t’i hapte ndonjë drejt një haxhiu që e pagëzoi veten “Xhixhi” apo një “Drite” që u rilind si Lucia, por mbase formula e ekuacionit të njohjes së jashtëzakonshme teorike të Italisë pa e shkelur fare akoma bashkuar me domosdoshmërinë praktike të fshehjes së gjurmëve të të qenit shqiptar gjatë atij impakti të ububushëm të albaneseve me pasqyrat mediatike shpjegon fuqinë vettransformuese që i bëri qindra mijëra shqiptarë të Italisë të përshtaten me një shpejtësi mbresëlënëse duke arritur suksese të rralla në botën e emigracionit shqiptar qysh në brezin e parë të të ardhurave (ovacione).

KOMENT: Qëllimisht një fjali e stërgjatë, për të hedhur disa “mina” njëkohësisht derisa tjetri të çorientohet e të topitet dhe të mos ketë mundësi t’i ofrojë as vetes shërbimin e analizës objektive. Pra synimi i Edi Ramës është që mendimin të mos e thotë në mënyrë të qartë dhe të ketë një reagim, qoftë edhe nga një sallë që e ka formatuar vetë, ndaj zgjedh struktura sabotuese të analizës. Ne po i riformulojmë mendimet e tij me copa dhe do të shohim problemet: “Ju shqiptarët e Italisë nuk i ndërruat emrat”. Qartësisht manipulim. Kryefjala duhej të ishte “Italia nuk ua ndërrroi emrat” ose më saktë do të ishte “qetë me fat që zgjedhët një shtet që nuk ua ndërronte emrat”. Viojmë me copëzën e fjalisë së stërgjatë “siç u ndodhi tragjikisht qindra mijëra vëllezërve dhe motrave tona në Greqi për një arsye të vetme dhe të lemeritshme që e dimë shumë mirë që të gjithë dhe që do të mbetet një njollë turpi në historinë e Europës demokratike”. Kjo nuk është njollë turpi për Evropën Demokratike, por është njollë turpi për klasën politike shqiptare. Është ajo që duhej ta detyronte Greqinë të mos kishte politika të tilla.

Për kë duhet të jetë njollë turpi fakti që Edi Rama i lejon vetes një tur të paktën një milion dollarësh ndërkohë që shkollat shqipe nuk marrin veç disa kacidhe nga shteti shqiptar? A nuk e ndihmon kështu ai asimilimin e shqiptarëve? Humbja e gjuhës është shumë më e rëndë sesa ndërrimi i emrit. Kush e ndaloi shtetin shqiptar të investojë që televizionet e ndjekura, shkollat publike shqipe, botuesit shqiptarë, ministritë, ambasadat të viheshin në punë të plotë për të mbrojtur sa më shumë identitetin shqiptar të diasporës? Asgjë tjetër veç interesit të klasës politike që ky asimilim të ndodhë sa më parë dhe ata të mbeten me të nënshtruarit në Shqipëri. Një diasporë shqiptare që ka lidhje të fuqishme me shtetin amë është sigurisht një oponente e fortë dhe komponent i fortë i opinionit publik, ndaj hakmarrja e “klasës politike” shqiptare bëhet kryesisht përmes “varfërimit të menisë shqiptare” dhe ky tur është pikërisht një tallje e rëndë me diasporën shqiptare. Në këtë aksion ka marrë pjesë e tërë Partia Socialiste.

CITIM: Mbase fuqia e verbër e **dashurisë platonike për Italinë** e transformuar në forcën e brendshme të një hakmarrjeje nga zilja e alarmit “E stato un albanese” e cila sa herë e dëgjonin i shtynte më fort shqiptarët t’i provonin Italisë “No, non stato io” shkaktoi atë lëvizjen e madhe nga **terreni rrëshqitës së leckamanëve të lagur kokë e këmbë**, të parë në rastin më të mirë me **sytë e mëshirës kristiane**, në terrenin pjellor të një komuniteti që jo vetëm e fitoi luftën me paragjykimet po nxori dhe ngjiti yjet e vet në majat dikur më të ëndërrta të Italisë, në palkosheniko të Sanremos, në tempullin e La Scalës, në spektaklin e Amicit, në podiumin e fituesit të Voice of Italy, në stolin e drejtuesve të skuadrave të serisë A, në kopertinat e librave të Einaudi dhe Feltrinellit, në bienalen e Venecias dhe nëpër muret e muzeve dhe galerive prestigjioze të arteve të bukura, në çdo maj province apo komune, ku krahas italianëve, shqiptet shkëlqyen me talentet, me bëmat dhe me vullnetin e tyre të jashtëzakonshëm.

KOMENT: Ndërkohë që bilancet e “dashurisë për Shqipërinë” i dalin keq, merret me bilancin e **“fuqinë e verbër të dashurisë platonike për Italinë”**. Manipulim i pastër dhe shmangie nga detyrimi shtetëror dhe kombëtar për t’u marrë me punët e Shqipërisë. Të flasësh me diasporën shqiptare për “dashurinë dhe

mallin për Shqipërinë” duhet të jetë detyrim shtetëror, kombëtar, moral. Çdo gjë tjetër është tallje ose shpenzim kohe kot. Sukseset e shqiptarëve në Itali, janë kryesisht suksese të shkollës italiane përkatëse. Nëse ato janë suksese të shkollës shqiptare të asaj fushe (balet, kanto, etj), atëherë kjo duhet të jetë një arsye më shumë që t’i tërheqë emigrantët e t’u thotë *“E shihni që shkolla shqiptare është e suksesshme edhe jashtë? Pra shkollimi shqiptar na genka me cilësi dhe ju duhet të vini, se ne mundemi të bëjmë sukses dhe me stilin e arsimit që kemi”*. Pse nuk e thotë këtë? Sepse misioni i turit në diasporë është *dekurajimi i kthimit në atdhe dhe nxitja e asimilimit të shpejtë*.

CITIM: *“Tu proverai sì come sa di sale lo pane altrui, e com’è duro calle lo scendere e l’alir per l’altrui scale.”* shkruhet në një nga këngët e Komedisë Hyjnore, pikërisht aty ku paraardhësi i tij Cacciaguada, i thotë Dantes një profeci se do të ketë një jetë në emigracion si ajo që ai kishte kaluar vetë. Ajo këngë duket si e shkruar për shqiptarët e Italisë kur thotë “Ti do ta provosh si shijen e kripës në bukën e tjetrit se çfarë vuajtje është që shkallët e tjetrit t’i zbresësh e t’i ngjitësh” (ovazione) “Tu lascerai ogni cosa diletta / più caramente; e questo è quello strale / che l’arco dello essilio pria saetta” (Shigjeta e harkut të arratisë do t’i ketë paraprirë braktisjes të çdo gjëje që ti merrje me të mirë”. E pra ju, shqiptarët e Italisë, provuat më të pabesueshmen kur derdhët lot malli çurk për **Shqipërinë të cilën e kishit lënë me betimin ekstrem për të mos ia parë kurr më sytë** dhe lotë të nxehta inati për Italinë që e kishit gjetur me besimin ekstrem se nuk do t’ua lagte kurrë fytyrën me ujin e kripur të syve, por, tamam aty, në atë shteg fare të ngushtë, mes **atdheut të mallkuar që e latë pas kurrizit**, duke rendur si ai fati i Shqipërisë të ngritur nga varri dhe atdheut të dytë këtu që u përplas mbi ju si i marri, duke iu shkelur dhe duke iu përmbysur bashkë me thesin e ëndrrave tuaja, ju gjetët Atdheun më të sigurtë, vetveten.

KOMENT: Vijon teknika “bëj fjali të gjata” që hapin disa teza njëkohësisht, një sallatë e qëllimshme që vetëm ai ta menaxhojë kuptimin dhe të topitë dëgjuesin që mund të thotë *“Po unë nuk jam i çmendur të merrem me të tillë fjali fyese për nga sintaksa e përdorur qëllimisht për të më ngatërruar”*.

Megjithatë do t’ia zbërthejmë në copa e të shohim se çfarë ka

thënë. Megjithëse “malli për Shqipërinë” është leva e Arkimedit që duhet ta kthejë emigrantin në Atdhe, ai e prek qëllimisht në gjuhë italiane. Ernest Koliqi është ai që ka shkruar poezinë më poshtë, duke përdorur të njëjtin citim që Edi Rama citon.

Vini re sa shumë ndjesi ndryshojnë nga arsyetimi e komunikimi i Edi Ramës deri tek poeza e Ernest Koliqit:

Ndoshta m'ka marrun gjumi tue lexuemun,
o Dant, poemën t'and me duer ndër tamtha,
pse nesër n'klasën t'ime më vjen rendi
t'zhvilloj at vargun plot me lot, at vargun
e mërgimit: “*Sa fort i ndiehet krypa
bukës së huej edhe sa shteg i ngurtun
asht zbritja e ngjitja nëpër shkalla t'hueja ...*”

Un sakt jam n'andërr e mërgimi i Dantit
m'ban t'a shof veten n'nji dhe t'hueja ...”

Un sakt jam n'andërr e mërgimi i Dantit
m'ban t'a shof veten n'nji dhe t'huej mërgue ...
por tekemramja mue kumbonza e shkollës,
qi vje n'çdo orë e na kallzon detyrën,
ka me m'a hjek'kët angh kur do t'më zgjoje
n'mes shokve t'dashun të kolegjes s'eme ...

Ah jo, or mik, vërte jan'kumbon' t'hueja
qi qajn' tue tingullue n'nji qiell mërgimi ...

Në fakt, Edi Rama jo vetëm që nuk i hyn “mallit për Shqipërinë”, por e turpëron atë me fjalët “**Shqipërinë të cilën e kishit lënë me betimin ekstrem për të mos ia parë kurr më sytë** “. Në fakt, betimi ekstrem mund të jetë për klasën politike, pra edhe për atë vetë e qeverinë e tij, por jo edhe për Shqipërinë, e cila është atdheu i trashëguar prej brezash, por i zaptuar nga klasa politike. Ai e quan të mirëqenë këtë betim, e përgjithëson për të gjithë. Vini re “transplantin” e emocioneve në këtë vijim fjalie “*dhe lotë të nxehta inati për Italinë që e kishit gjetur me besimin ekstrem se nuk do t'ua lagte kurrë fytyrën me ujin e kripur të syve, por, tamam aty, në atë shteg fare të ngushtë, mes **atdheut të mallkuar që e latë pas kurritit**, duke rendur si ai fati i Shqipërisë të ngritur nga varri (aluzion për Naim Frashëri tek “Histori e Skënderbeut”) dhe atdheut të dytë këtu që u përplas mbi ju si i*

marri, duke iu shkelur dhe duke iu përmbysur bashkë me thesin e ëndrrave tuaja, ju gjetët Atdheun më të sigurtë, vetveten.”. Pra e quan të mirëqenë dhe në një stil gati adhures për “*lotët e nxehta të inatit për Italinë*” (gati sa s'thotë “*lotë malli për Italinë*”). Me çfarë të drejte, Edi Rama shtrembëron reflektimi e diasporës duke thënë “*atdhe i mallkuar*”? E mallkuar mund të jetë klasa politike, por jo edhe atdheu. Edi Rama ia ngec “mallkimin” atdheut, sepse dëshiron ta përgjithësojë “mallkimin” nga pjesa që është “klasa politike” tek “atdheu” që është edhe Atdheu i Skënderbeut, edhe i gjyshërve, edhe i Rilindjes Kombëtare edhe i shekullit 20 edhe i shekujve që do të vinë, edhe i racës shqiptare që sigurisht do ta gjejë rrugën. Por Edi Rama i është vënë këmbë mbas këmbë çdo reflektimi dhe po hyn në qelizat e reflektimit dhe të “transplatojë / injektojë aty” propagandën e vet për “atdheun e mallkuar” për diasporën “por shumë të dashur” për Partinë Socialiste. Çfarë është “**gjetët atdheun më të sigurtë, vetveten**” veçse tallje me konceptet e rëndësishme që nuk duhen tjetërsuar dhe zëvendësuar.

CITIM: Zbuluat brenda jush forcën e pandalshme për të ndjekur nga mbrapa të ardhmen tuaj, pa u dorëzuar kurrë mes e përmes, purgatorit të plagëve të reja, kur ato të **ferrit të vjetër** akoma nuk ishin mbyllur, duke e shtrënguar fort besimin tek vetja, tamam siç shtrëngonte Dantja dorën e Virgjilit.

KOMENT: Unë jam duke shkruar komentet e mia me tekstin para që e kam shkruar vetë, se Edi Rama nuk e boton, që do të thotë se nuk dëshiron t'i lërë publikut një material të dokumentuar. Ai do që publiku të kënaqet me “jehonat” dhe pastaj ai ta sulmojë analizën duke thënë “nuk më ke dëgjuar mirë”, “nuk po më referohesh mirë”, pra krejt i interesuar për “ngatërrimin e kuvendit”. Lasgush Poradeci, kur referon gjuhën e pastër të Naim Frashërit thotë:

*... Të përmbysim vetëdijen, kur na fton mburim i jetës?!
... Të mendojmë kaqe errët mun në mes të së vërtetës?!
... Ta mjerojmë kuvendimin me kaq helm e kaqe prishmë
Kur fillon t'ja thotë shqipja me një hir të perëndishmë?!*

*Sepse hir të perëndishmë kish kuvendi yt, Naim,
Ajo këng' e tepërlumtur që më s'pati shëmbëllim;
Se mendimi yt kish flakën e kuptimit të kulluar,
Goja jote vjershëtore kish një zë të pastërtuar;*

Edi Rama qartësisht përmbys vetëdijen kombëtare dhe i çon ndjesitë e diasporës në një ujë të turbullt. Me çfarë të drejte ai bën “*transplant ndjesish përmes krahasimesh e metaforash të errëta*” dhe e quan “*ferr të vjetër*” atdheun dhe i referohet drejtimit për nga Italia si “*shtrëngim fort të besimit tek veje siç Dantja shtrëngonte dorën e Virgjilit*”, në gënjeshtëri të plotë, a thua se shqiptarët e fshatrave e qyteteve të Shqipërisë po niseshin drejt Italisë me librin e Dantes në gji? Kinse për t’i bërë “të kulturuar”, ai thotë të pavërteta për formimin e Shqiptarit dhe na turpëron duke thënë se edhe shkolla shqiptare nuk u ka mësuar kulturë shqiptare atje në Shqipëri por janë dalldisur shqiptarët pas Dantes dhe Virgjilit, siç referon Edi Rama.

Shqipëria është shumë e kulturuar pikërisht se ka poetët e saj të fuqishëm dhe poezia shqipe ishte aq e fuqishme dhe kombëtare sa u bë bazë e vetëdijes kombëtare që u formua gjatë Rilindjes Kombëtare të shekullit 19, idhtarët e së cilës në Greqi Rama i quajti “fosile të gjalla të shekullit 19”.

CITIM: Virgjili është ai që i la njerëzimit edhe rrëfimin për forcën e pashtershme krijuese të emigrantëve, përmes personazhit kryesor të kryeveprës së tij Eneidës. Enea, refugjati i arratisur, nga zjarret dhe nga lemeritë e luftës së Trojës, ndalet në Butrintin tonë për të mësuar fatin e tij dhe, pikërisht në Butrint, kjo Trojë e vogël, siç e quan Virgjili, Enea mëson fatin e tij përmes një profecie. Në fund të udhëtimeve të rrezikshme do të themelosh Romën e lavdishme (ovacione). Përtej mitit, rrëfimi i Virgjilit na zbulon se çdo kështjellë politike është ndërtuar me gurë të mbledhur nga shtresat e kohës, çdo identitet e ka zanafillën me një të ardhur diku nga diku, çdo bashkësi e krijuar nga politika si entitet juridik, në shtratin e gjeografisë, nuk është asgjë tjetër, vetëm një përzierje, ripërtëritëse e elementëve që në një epokë apo në një tjetër, janë ndërthurur në përfaqimin e të ardhurve më parë dhe atyre që kanë ardhur më pas me njëri-tjetrin. Edhe në këtë pellgun tonë mesdhetar.

KOMENT: Ndërkohë që shkollat e Italisë, natyrshëm i kanë të parashikuara në programet e tyre mësimore këto mësimë, Edi Rama u shton edhe një “dozë tjetër” mësimësh në mitingun e tij. Një anëtar i diasporës shqiptare nuk pret nga shtetari shqiptar t’i bëjë terapinë psikologjike të “*transplantit kulturor e identitar*”

që ia bën më mirë Italia, por pret të dëgjojë për gjuhën shqipe, kulturën shqiptare, historinë shqiptare, objektivat kombëtare të rikonceptuar në këto kushte, për investimet shtetërore në diasporë. Edi Rama duket sikur ka ardhur për të venë qetësues në shpirtin e diasporës, ndaj komunikon “*Përtej mitit, rrëfimi i Virgjilit na zbulon se çdo kështjellë politike është ndërtuar me gurë të mbledhur nga shtresat e kohës, çdo identitet e ka zanafillën me një të ardhur diku nga diku, çdo bashkësi e krijuar nga politika si entitet juridik, në shtratin e gjeografisë, nuk është asgjë tjetër, vetëm një përzierje, ripërtëritëse e elementëve që në një epokë apo në një tjetër, janë ndërthurur në përfaqimin e të ardhurve më parë dhe atyre që kanë ardhur më pas me njëri-tjetrin. Edhe në këtë pellgun tonë mesdhetar.*”

Me pak fjalë, mos e mbani mendjen tek “identiteti shqiptar” por shihni çfarë bëhet me identitetin e ri që në rastin e emigrantit s’ka se si të jetë tjetër veç një *identitet hibrid*, dhe një krizë identiteti aq më tepër kur sheh kryeministrin e vendit tënd që në vend të ta zbukurojë ditën me mallin e atdheut, të bën terapi psikologjike për të noterizuar “humbjen”. Në thelb, është edhe pak sadiste kjo qasje. Nëse nuk mund të bësh gjë, thjesht “hesht” dhe mos ua ngacmo plagët me “identitet europian”, me Virgjil, me Dante, apo me Enea, Bubulina, Platon etj që qenka në dorën e një emigranti të braktisur nga shteti i vet.

Atë që mund të bëjë emigranti është të furnizojë kulturën italiane ose greke me elementë të fuqishëm të kulturës shqiptare, por që ai ta bëjë këtë, duhet të ketë shkollën shqipe në komunitet, nuk mund ta bëjë si t’i vijë për mbarë. Shkolla shqipe do të jetë e situar në programet e saj. Edi Rama nuk investon në shkolla shqipe në diasporë e thotë pastaj “*kontribute në identitetin europian*”.

Naimi do të thoshte: “*Oh, sa qenë të gënijer ata që vuan për botë, turp të madh kanë rrëfyer, u munduan fare kotë*” ose “*Lanë mëmëdhenë të çveshur dhe mundohenë për botë, pa dhe bota, duke qeshur, U thotë: mundohi kotë!*” (Këtu e kemi fjalën për propagandën e kryeministrit dhe jo për përjetimet e emigrantit) Pse e thotë “identitet europian” sepse e di që është një “mall pa zot” dhe kush të dojë mund ta lëshojë “imagjinatën” dhe të lëshojë “përrenjtë e emigrantëve” në këtë “det të turbullt identitar” që Edi Rama e zbukuron me fjalët “identitet europian”.

Sigurisht që ka edhe identitet europian, por ai nuk qëndron më vete, por qëndron si e përbashkëta ndërmjet identiteteve kombëtare dhe nuk ekziston më vete. E vetmja gjë që duhet mësuar realisht përtej “vetëdijes kombëtare” është “vetëdija globale”.

Nuk mund të ketë “vetëdije europiane”, ose ka vetëdije “italiane”, “greke”, “shqiptare” ose tjetra është “vetëdija globale”. Çdo gjë tjetër mund të jetë një farë interesi rajonal, por bota ka rënë dakort të investojë në këto dy qasje. Detyrë e kryeministrit është të bëjë bilancin e “vetëdijes kombëtare shqiptare” se për atë “italiane” apo “greke” apo “gjermane”, “britanike” ka kush mendon. Të gjitha shtetet njëkohësisht duhet të investojnë edhe në vetëdijen globale dhe këtu janë sistemet arsimore. Në librin Global Albania (Artur Shkurti, prill 2024) është kapitull më vete.

CITIM: Ju shqiptarët e Italisë dhe ata të Greqisë më së pari jeni sot një nga **shembëlltyrat domethënëse të një profesie të përbashkët**: themelimit të një qytetërimi të ri europian, më i lirë, më i drejtë, më gjithëpërfshirës sesa paraardhësit e tij grekë dhe romakë (ovacione), fundi i hidhur i të cilëve mëson këdo që do të mësojë se edhe realitetet politike në dukje më të çelika mund të rrënohen si kështjella rëre kur etja për pushtet e individëve që duan të kontrollojnë të djeshmen gërryen deri në sakrifikim vlerat e përbashkëta njerëzore dhe e kthen të përpjetën sfiduese drejt së ardhmes në të tatëpjetën shkatërruese të së shkuarës (duatrokitje).

KOMENT: Dëshira për ta “kamufuar” mendimin e çon edhe në togfjalëshja të tipit “shqiptarët” si “shembëlltyrë domethënëse e profesisë së përbashkët”. Me përkufizim, “profecia” është një parashikim ose një deklaratë... atëherë si mund të jenë shqiptarët e Italisë dhe të Greqisë shembuj të “deklaratave” dhe “të parashikimeve”? Nga ana tjetër si mund të jetë “themelimi i një qytetërimi europian” një “profeci” kur mungon referenca e një deklarami të tillë nga dikush (profeti)? Pra thjesht nga ana logjike formale mendimi çalon rëndë, por ai për këtë punë e bën, që të “trullosë” mirë e mirë. Etja e madhe për propagandë e “nakatosje” idesh, e bën të bjerë në të tilla struktura absurde për nga logjika formale. Tjetër është ta kesh mendimin dhe idenë gabim e tjetër ta kesh plotësisht gabim nga ana e formulimit. Megjithëse mendimi është krejt i ngatërruar dhe jologjik, kjo nuk e ka ndaluar sallën të duartrokasë pas frazës “profetike” “themelimit të një qytetërimi të ri europian, më i lirë, më i drejtë, më gjithëpërfshirës sesa paraardhësit e tij grekë dhe romakë”. Ta marrësh sallën e ta pyesësh: “Pa na i përsërisni edhe një herë se çfarë tha! Pse duartrokisni kot kur qartësisht është e ngatërruar dhe logjikisht gabim?!”.

A ka strukturë më të errët mendimi sesa kjo që thotë:

“Ju shqiptarët e Italisë dhe ata të Greqisë më së pari jeni sot një nga **shembëlltyrat domethënëse të një profesie të përbashkët**: themelimit të një qytetërimi të ri europian, më i lirë, më i drejtë, më gjithëpërfshirës sesa paraardhësit e tij grekë dhe romakë (ovacione), fundi i hidhur i të cilëve mëson këdo që do të mësojë se edhe realitetet politike në dukje më të çelika mund të rrënohen si kështjella rëre kur etja për pushtet e individëve që duan të kontrollojnë të djeshmen gërryen deri në sakrifikim vlerat e përbashkëta njerëzore dhe e kthen të përpjetën sfiduese drejt së ardhmes në të tatëpjetën shkatërruese të së shkuarës (duatrokitje).

Kjo “nakatosje” mendimi e tipit “mbaje se më zuri”, është e qëllimshme për të trullusur sallën, median, dhe këdo që do ta marrë në analizë, që me të drejtë mund të thotë “Po mua nuk më kanë lënë mendtë e të merrem me të tilla fraza”. Kaq do edhe autori e të thotë “Atëherë dil nga rreshti i analizës” dhe “prit për ndonjë gjë më të qartë”.

Synimi i sulmit DDOS (Distributed Denial of Service) është që përmes kërkesave të shumta fiktive nga kompjutera “bot” të bllokohet dhënia e shërbimit. Kështu funksionon edhe me fjalimin. Qëllimisht mbushet me struktura (bot) që i ngajnë bombardimit me ide të ndryshme brenda të së njëjtës fjali, në atë mënyrë që dëgjuesi “të rehatohet” në bindje të verbër ndaj fjalimit. Sigurisht që Edi Rama di se si flitet qartë, ndaj nëse po flet “kështu” e ka të qëllimshme. Ndaj kritika jonë nuk është në drejtimin a është i zoti apo jo të flasë qartë, por pse ka zgjedhur të tillë “ligjërim” e të tilla ide. Shekspiri thotë “S’ka gjë të mirë apo të ligë, pa një qëllim të mirë ose të ligë”.

CITIM: Përpara se t’i jepte lamtumirën Elenit dhe Andromakës në Butrint. Enea, në vizionin e qytetërimin do të sillte lulëzimin e të tjera viseve në Itali, ëndërrone që vëllezër prej shpirti dhe dashurie popujt e krejt asaj zone do të ndërtonin një atdhe të vetëm të përzierë dhe të shtruar nga një fat i përbashkët në kufirin me Lindjes dhe Perëndimit.

KOMENT: Është e qartë që po bën “psikologun e asimilimit”. Emigranti e di që kultura e tij është hibride, zakonisht në dy gjuhë, pra “italo-shqiptare”, ose “greko-shqiptare” etj.

Nga ana tjetër, Edi Rama refuzon të flasë për ndarjen që tashmë është e qartë në shkollat ndërkombëtare, në ministritë e arsimit apo në universitetet e edukimit dhe që janë konceptet **kompetencë globale** dhe **vetëdije globale** dhe **vetëdije kombëtare**. Kjo se ato janë të përkufizuar duke përdorur njëra-tjetrën, duke plotësuar njëra-tjetrën dhe kjo do ta kërkonte me detyrim që folësi të shprehej për raportin me “vetëdijen kombëtare”. Mirëpo aty gjërat do të komplikoheshin rëndë, sepse do të dilte përgjegjësia e shtetit amë, ndaj ai e përdori shtetin amë në kontekstin më të errët “*atdhe i mallkuar*”, pra në kuptimin “*mos t’u marrë më malli për Shqipërinë*” (atë ma lini mua, ju shihni Danten, Virgjilin dhe Enean apo Bubulinën). Kur jemi tek *vetëdija kombëtare*, një është ajo “shqiptare” por një tjetër është ajo “italiane” ose “greke”. Ndaj “vetëdija globale” nuk është baraz me “vetëdijen e huaj” kur ajo vjen në mënyrë kombëtare, ta zemë “italiane”, “gjermane”, “angleze”. Vetëdija globale është unike dhe një për të gjithë botën. Kompetenca globale është fjala e duhur për aftësinë e duhur. Këshilltarët e tij të fjalimit, të zhytur vetëm në histori dhe jo edhe në teori edukimi, nuk e dinë që të gjitha Ministritë e Arsimit në botë po përdorin terminologjinë e duhur për “vetëdijen globale” dhe “kompetencën globale”, krahas “vetëdijes kombëtare”. Në çështje të “vetëdijes dhe kompetencës globale” emigranti mund të jetë më para sesa të tjerët, sepse i vuan problemet e botës më herët se të tjerët t’i përfytyrojnë. Në këtë arsytim e kemi bërë në librin “Global Albania” (shih faqet 10-11) me titull “Vetëdija globale dhe kompetenca globale”.

CITIM: Të përziera dhe të mishëruara ndaj njëra-tjetrës i kemi pasur historitë tona ne popujt në këtë zonë dhe një prej shembëlltyrave më domethënëse të asaj përzierje është ajo e kohës kur fisnikëria shqiptare fitoi qytetarinë venedikase, bashkë me të drejtën e përfaqësimit, dhe kur Skënderbeu ynë u bë flamuri i qëndresës së Perëndimit ndaj furisë së ardhur nga Lindja dhe u nderua nga Selia e Shenjtë me titullin e madh të Atletit të Krishtit (ovacione), por, nga ana tjetër, njihet botërisht, edhe fakti se Heroi ynë kombëtar ishte edhe një luftëtar besnik i Mbretit të Napolit me të cilin e lidhte fakti që i hapi rrugë konsolidimit të një bashkësie shqiptare që nga Pulja deri në Siçili ku ruhet në 51 komuna italiane sot e gjithë ditën gjuha e arbërisë skënderbejane (ovacione).

KOMENT: Sjellja e shembullit “arbëror” të ruajtjes së gjuhës është për t’i thënë sallës se edhe pa investime shtetërore ajo mund të ruhet në gjendje të egër që është krejt gabim. Shteti duhet të investojë në gjuhën shqipe, në botimet shqipe, sepse është përveç të tjerave jo vetëm një detyrim kushtetues por edhe një biznes shumë i fuqishëm kombëtar. Nuk duhet që të nxitet “asimilimi” pra humbja kombëtare. Duket sikur Edi Rama dhe Partia Socialiste kërkojnë ta sabotojnë me vetëdije këtë mundësi të artë që i jepet kombit tonë, që ka mundësi ta tërheqë diasporën e saj atëherë kur ajo është shëndosur. Përmbajtja e fjalimeve të Edi Ramës në Greqi dhe në Itali nuk lënë as më të voglin dyshim për këtë. Sjellja e Ministrisë së Jashtme dhe e Qendrës Kombëtare të Diasporës gjithashtu nuk lënë më të voglin dyshim.

CITIM: Prej atyre rrënjëve të vjetra arbërore dolën në shekuj familje të mëdha dhe individë të shquar që lanë gjurmë në historinë e Italisë, albanët prej të cilëve doli edhe një Papë shqiptar, Durracët e Xhenovës, Krispët (!) e Risorgimentos, Gramshët e rezistencës antifashiste, dhe plot të tjerë.

KOMENT: Nën shembullin e Bubulinës së Greqisë, këtu do të vijmë shembuj të tjerë. Edi Rama nuk zgjedh të frymëzojë emigrantët me sjelljen e asaj diaspore shqiptare që bëri Rilindjen Kombëtare, por sjell shembuj të asaj diaspore që ka punuar për vendet e tjera. Shumicën e rilindasve të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare të shekulli 19 dhe të fillim-shekullit 20 i kemi patur në diasporë. Ata punuan për Shqipërinë. Pse nuk ua jep si model Edi Rama? Çfarë leverdie ka Shqipëria dhe kombi shqiptar nga shembuj si Bubulina apo Durracët e Xhenovës etj? Ndryshojnë arbëreshët sepse ata kanë investuar në gjuhën dhe kulturën arbërore pra kanë investuar në kulturë kombëtare deri në atë çast sa sot shteti shqiptar dhe institucionet akademike shqiptare e kanë më të lehtë t’i ndihmojnë të fitojnë hapa të tjerë drejt bashkimit gjuhësor dhe pasurimit të fjalorit dhe të strukturave në atë mënyrë që ky identitet arbëror të marrë një shkëlqim më të fuqishëm.

CITIM: Ju, shqiptarët e Italisë, *e këputët me forcën e mërisë ndaj diktaturës të varfërisë dhe me me duart e ëndrrave për Europën e mirëqënies kërthizën me tokën mëmë*, përmes po atij deti, ku paraardhësit tanë të vjetër, arbëreshët e panë që t’u këputet ajo kërthizë me shpatat e makthit të tyre dhe,

ndryshe nga ju që jeni katranipët e sotëm të Skënderbeut, që vetëm pak vite më pas larg Shqipërisë rifilluat të ktheheni për t'u çmalluar me rrugët e vendlindjes, ata vëllezërit dhe motrat e Gjergj Kastriotit kapërcyen shekujt në pamundësi për ta riprekur me sytë e përmalluar Arbërinë. (ovacione) Arbëria vdiq, pas lëngimesh të gjata shumë larg syve të tyre dhe u ringjall me emrin Shqipëri dhe me një flamur të ri ndërkohë që trojet arbëreshe të Italisë mbetën sëndyku i rrobave, i qirinjve dhe i kujtesës së Arbërisë, mbuluar me flamurin e vjetër të legjendës dhe të historisë së heroit tonë kombëtar.

KOMENT: Qartësisht është terapi psikologjike “harrese” dhe “ngatërrese” të kujtimeve dhe të vlerësimeve. Edi Rama identifikon “diktaturën e varfërisë” me “tokën mëmë”. Ai, në emër të tij, por jo edhe në shpirtin e pastër të një shqiptari të diasporës, zbukuron çastin e shkëputjes nga atdheu dhe mekanizëm për këtë bënë “mërinë ndaj diktaturës së varfërisë” dhe “ëndrrat për Europën e mirëqënies”. Ai bën sikur i afrohet temës ku mërgimtari do t’ia kishte qejfi të dëgjonte arsyetimin, dhe i largohet me shpejtësi “rrufe”. Mund të lexohet edhe një herë dhe do të shihet që është saktësisht kështu. Ai e çorienton mendjen e dëgjuesit duke vendosur paralelizma të stërzgjatur me Arbërinë, për të fshehur “faktin e kryer” dhe vendimin e tij që do të ishte “Për mendimin tim: mos u ktheni në atdhe”, “shiheni veten sikur jeni arbëresh që tani si të bëhet si të mos bëhet Shqipëria”. Kjo është sepse, me sa duket, ai e do për vete dhe për Partinë Socialiste dhe për të nënshtruarit e tyre Shqipërinë. Të tjerët do t’i plotësojë me të huaj. Pra kail është që të mos vijnë shqiptarët dhe ai të drejtojë vendin, sesa Shqipëria të jetë një vend i shqiptarëve.

CITIM: Por, nga ana tjetër, janë shumë domethënëse edhe gjurmët historike të Italisë në Shqipëri, aty ku Jul Qesari sfidoi Pompeun, aty ku Napoli, Amalfi, Venecia sollën tregtarë dhe arkitektë, ngritën kisha e ndërtime. Aty ku Kështjella e Rozafës së Shkodrës u kthye në simbolin e rezistencës veneciane kundër fuqisë otomane dhe u përjetësua në pikturën e një gjeniu të Rilindjes italiane Paolo Veroneses, e cila qëndron, sot e gjithë ditën në sallën e këshillit të madh në Venecia. Ato gjurmë shtrihen nëpër trupin e Shqipërisë ndër shekuj drejt kohëve më të vona deri aty ku mori jetë plani urbanistik i arkitektëve italianë mbi të cilin

u vu dhe guri i parë i Tiranës moderne dhe më pas aty ku nga përqaftimi i dhunshëm i Shqipërisë dhe i Italisë fashiste shtrënguar mes historisë së një fuqie të madhe adriatike që e kishe parë mëmëdheun tonë si simotër dhe fuqisë megallomaniake të një Italie të verbuar nga ëndrrat e vjetra perandorake u hap një plagë e rëndë prej së cilës mbeti lavdia e Luftës Antifashiste po edhe gjurma e kulturës së asaj kohe që sot e gjithë ditën është e shënjuar shumë fort në asamblin historik të bulervardit kryesor të Shqipërisë. (ovacion)

KOMENT: Ky paragraf duhet për të marrë kohën e dëgjuesit.

CITIM: Të dashur bashkëatdhetarë shqiptarë, Tek ju shqiptarët e Italisë, dhe po njësoj shqiptarë të krejt Europës, unë shoh sikur ka marrë mish e shpirt shprehja e një emigranti të madh Shën Pali, i cili i ra Mesdheut kryq e tërthor me të atilla peripeci që vetëm ju mund t’i kuptoni me mendje dhe me trup deri kur solli Fjalën e Mirë të dashurisë së Zotit në këtë tokë të bekuar të Italisë pasi e shpalli atë siç vetë e dëshmon në të gjithë Ilirinë. “Luftova betejën e drejtë, e ndala tashmë vrapin, e ruajta besimin dhe pres vetëm atë që më takon: Kurorën e Drejtësisë” (ovacione).

KOMENT: Në fakt Kurora e Drejtësisë do të jetë Certifikata “Atleti i Asimilimit” që nxitet edhe nga kryeministri i Shqipërisë, certifikatë që do t’i jepet nga shteti pritës, në këtë rast Italia, ose Greqia, ose Gjermania, apo Britania e Madhe. Shqiptarët kanë një ritëm të lartë asimilimi pikërisht prej pikës së tyre më të fortë që është aftësia për t’u përshtatur, aftësia në përvetësim të gjuhëve të huaja, kurioziteti për kulturat e huaja, pranimi i sfidës. Të gjitha këto aftësi duheshin shfrytëzuar për interes kombëtar, por kryeministri bën sikur e ka mendjen tek “Kurora e drejtësisë” që në fakt, nuk do ta marrë emigranti por do ta marrë ai vetë bashkë me Partinë Socialiste që do të quhen të përshtatshëm për qeveritë ndaj të cilave bëjnë këtë koncension gjigand “asimilimi” të pakërkuar. Kryeministri me sa duket ka marrë oferta të tjera për shqiptarë të tjerë drejt këtyre shteteve dhe vetë Shqipëria do të kthehet drejt Filipineve. Me sa duket kontratat me Filipinet i lehtësojnë edhe Greqia, Italia, Gjermania, Britania e Madhe.

CITIM: Sot ju këtu në Itali jeni afro 700 000 banorë me leje të rregullt qëndrimi dhe më shumë se 1/3 juaj afro çerek

milioni jeni qytetarë me pasaportë italiane dhe me të drejtë vote në vendimmarrjen demokratike të këtij vendi (ovacione).

KOMENT: Raporti i Ministrisë Italiane të Punës dhe të Politikave Sociale, i vitit 2023 “*La comunità albanese in Italia - rapporto annuale sulla presenza dei migranti*” thotë se në janar 2023 ka patur 389 646 shqiptarë me qëndrim të rregullt. Kryeministri jep një shifër që është 310 000 më shumë, ose 80% më shumë nga sa thotë vetë qeveria italiane. Ministria Italiane e Punës thotë se 23.5% janë minorenë, që sipas statistikave të tyre i bie 91 000 minorenë, ndërsa nëse është si thotë kryeministri ynë, dhe duke mbajtur 23.5% si tregues të minorenëve i bie rreth 165 000 minorenë në Itali, që do të thotë se politika shtetërore për mbajtjen e gjuhës shqipe të tyre do të përfshinte të paktën 120 000 minorenë dhe kjo do të thoshte që të krijohen 10 000 klasa të gjuhës shqipe, dhe që do të donin të paktën 2000 mësues në të gjithë Italinë, për një ditë të vetme. Nëse do të paguheshin me 120 euro ditën e shtunë, do të thoshte që duheshin paguar rreth 200 000 euro vetëm për një fundjavë dhe nëse do të ishin 35 të tilla në vit, sa ne e kemi vitin shkollor, do të thotë që buxheti i shtetit vetëm për mësuesit e gjuhës shqipe në Itali do të duhej të parashikonte 14 milionë euro. Ja kjo do të ishte politikë kombëtare. A do të kthehesin këto para të investuara. Me siguri që do të ktheheshin, sepse do të thotë të mbash gjallë me gjuhë histori, interes një komunitet prej 700 000 vetësh që do të sillte çdo vit Shqipërisë të paktën 10-20 fishin e investimit mbi gjuhën e tyre. Ja kjo është llogaria kombëtare që duhet bërë. Pra nuk është vetëm “interes platonik” por është një interes i gjithanshëm, le ta quajmë “biznes kombëtar”. Ndërkohë kryeministri i Shqipërisë qëllimisht e lë pa prekur dhe pa analizuar këtë interes të lartë kombëtar dhe bën “sikur” arsimi shqip është “folklor”, ndërkohë që është biznes i fuqishëm kombëtar dhe mungesa e qëllimit e programit për gjuhën shqipe në këtë këndvështrim është thjesht një shitje e interesit kombëtar shqiptar.

CITIM: 3/5 tuaja janë të përqëndruar këtu në Veriun e zhvilluar italian. 10% e totalit të bizneseve të krijuara nga ata që kanë ardhur në Itali nga jashtë BE janë tuajat (ovacione) dhe sipërmarrjet e shqiptarëve që kontribuojnë me taksat e tyre në arkën e shtetit italian janë mbi 40 000 (duartrokitje). Studentët shqiptarë në universitetet italiane janë po ashtu

tu rreth 10% e gjithë studentëve të huaj nga vendet jashtë BE dhe mes të gjitha komuniteteve të huaja studentore të Italisë ai shqiptar renditet mes atyre me rezultatet më të mira. 421 mijë prej jush do të përfitojnë nga marrëveshja e sapolidhur e pensioneve me Italinë ku falë angazhimit personal të kryeministres suaj këtu në Itali, një mike e paepur e Shqipërisë, dhe një zëdhënëse shumë e fortë e jona në BE Xhorxhia Meloni, (ovacione) ne ia dolëm të vendosim, më në fund, pas një përpjekje të gjatë, po të palodhur dhe jetëvjeçare një gur të çmuar dhe të munguar në atë kurorën e drejtësisë që ju e keni merituar plotësisht me dashurinë, me stërmundimet dhe me kontributet tuaja për këtë atdhe të dytë tuajin ku ju e heshtët përgjithmonë ata zilen e paragjykimin të tmerrshëm “E stato un albanese” që ju shoqëroi në të përpjetën e mundimshme të sakrificave drejt triumfit tuaj, si europianët e rinj të Italisë (ovacione).

KOMENT: Të tëra sa tha më sipër janë përshkrim statistikor i përfitimeve që ka Italia dhe vetë këta individë të drejta që i kanë fituar vetë. Detyra e një kryetari shteti është të tregojë cili është interesi i Shqipërisë në këto që po thotë?

CITIM: Sot, unë kam ardhur këtu për t’ju thënë se edhe Shqipëria tanimë po e fiton njësoj si ju betejën e saj të drejtë pa e ndalur vrapin dhe duke e ruajtur të palëkundur besimin në kërkim të kurorës së munguar të drejtësisë për emrin e saj, flamurin e saj, vendin e saj, me Zot, me ligj, dhe me zakon në familjen e shteteve të Europës. Ua them vazhdimisht kolegëve të mi europianë “Vërtetë edhe për pak kohë ne nuk jemi ende të gjithë si popull edhe si shtet në BE, por të qenit europianë në mes të Europës, njësoj të barabartë, në nder dhe në dinjitet, me të gjithë të tjerët, nga Londra deri në Varshavë, nga Stokholmi deri në Athinë, shqiptarëve ua ka caktuar njësoj si gjithë europianëve i njëjti Zot (ovacione) dhe ne na e ka shkruajtur amaneti i Skënderbeut, i rilindasve, i dëshmorëve të shqiptarisë, ndërsa mbarë këtij kontinenti jeni ju që ia keni imponuar të parët se shqiptarët janë pjesë e Europës dhe ju jeni pjesë e bashkuar e familjes europiane (ovacione). Njësoj, siç ju e çliruat këtu në Itali emrin “albanese” nga ai kafazi i tmerrshëm i paragjykimave poshtëruese edhe Albania jonë sot ka dalë nga ai kafaz ku deri para ca vitesh e shikonin me nënçmim, e trajtonin

në rastin më të mirë si një krijesë misterioze dhe, në rastin më të keq, si një qenie inferiore, e mbushur me pleshtat e të gjitha të këqia, një vend i rrezikshëm i padepërtueshëm nga ligji, i mbështjellë nga pluhurat, i pushtuar nga plehrat që i bënte të gjithë shqiptarët në Europë që iu bënte edhe ju këtu në Itali të skuqeshit ku i zihej emri me gojë Albania (ovacione) por sot, sot ka ardhur dita që çdokush rrethrotull jush në lagje, në punë, e kudoqoftë nga italianët, kur i thoni Albania ju thotë “mezi po pres të shkoj me pushime”. (duartrokitje) dhe ka ardhur edhe dita, kur, nëse rastis ndonjëri që ju shef shtrembët keni të gjitha arsyet ta shifni me kokën lart dhe t’i thoni “C’è qualcosa?” (qesh salla dhe ovacione Edi!Edi!)

KOMENT: Edhe pse ka bërë një përshkrim sipas dëshirës zbukurose të Shqipërisë, ne po e marrim të mirëqenë sepse kështu na leverdis për hir të analizës. Në këtë drejtim kryeministri megjithëse u thotë gjëra “krenare” për Shqipërinë, nuk ia nxë goja të thotë “Ejani në Shqipërinë tonë! Pse të marrim të huaj kur ju kemi ju?! Pse ju të punoni për të huajt, kur mund të punoni për shtetin tuaj?!” A jua tha këtë? Jo. Atëherë çfarë po thotë? Po bën një “terapi psikologjike” mbi bazën e arritjeve që i quan *teknikë shkencore në propagandë* që ai e ka të përpunuar dhe mendon që e ka të suksesshme, ndaj ka marrë një hap të guximshëm dhe ka dalë nga Shqipëria në diasporë për ta shtrirë produktin e kësaj “teknologjie” e “terapije të re psikologjike” përmes propagandës.

CITIM: Për shumë vite ishit ju shqiptarët e Italisë dhe të gjithë Europës që e mbajtët Shqipërinë në këmbë me dërgesat për familjet tuaja. Sot, është radha e Shqipërisë t’ju bëj juve krenarë kur flisni për atdheun tuaj apo kur italianët dhe europianët e tjerë flasin për Shqipërinë dhe për dinjitetin e saj të fituar përfundimisht europian. (ovacione).

KOMENT: Kjo është “ikja me vrap” nga logjika formale. Ndërkohë që “nderi” shlyhet me të njëjtin “nder”, vini re se si e shpërblen Edi Rama nderin e diasporës. Pra ju na ndihmuat duke e mbajtur Shqipërinë me të ardhurat tuaja. Ne do t’ju ndihmojmë (me çfarë???) duke ju bërë “krenarë”. Pra fjalë të mira dhe gurë në trastë. Kjo është thjesht e turpshme. Kryeministri do të duhej të thoshte: “Ne do t’jua shpërbeljmë duke u bërë oferta familjarisht, si fshatra e krahina të tëra të ripopullojmë Shqipërinë

që ka shumë potencial, pra ju dhe fëmijët tuaj ta mbyllni jetën si shqiptarë dhe të mos bëhet realitet asimilimi i përhershëm”. Kjo do të ishte lëvizje e mirëfilltë kombëtare. Mirëpo ai duket është tepër xheloz për popullin e vet. Nuk ia do të mirën dhe sapo sheh që ka një udhë zhvillimi i hedh telat me gjemba që të mos kalojë kush nga ajo udhë.

CITIM: “Akil, Akil këmbëshpejti që rend brigjeve të detit” Kjo fjali e nxjerrë nga Iljada shqiptohet me zë të ulët nga një shqiptar që në vitin 1943 vuante si antifashist internimin në Ventotene.

“Në Ventotene”, shkruan Altiero Spinelli i cili është një nga etërit themelues të Europës së Bashkuar, “ai ishte afruar në mënyrë të natyrshme me ish-komunistët dhe ish-socialistët me të cilët fliste shpesh për djallëzinë e regjimit të Stalinit ose e shihje të ecte elegant, me kokën drejt, bukurosh me flokët bjond në erë duke pëshpëritur fjalët e Platonit që i lexonte në greqisht tek kërkonte kthjellësinë e shpirtit. Gjatë natës së 25-26 korrikut 1943”, rrëfen Spinelli, “ndërsa ishim mbyllur nëpër baraka, ishte hapur fjala se Musolini kishte dhënë dorëheqjen. Mëngjesin tjetër, të gjithë të internuarit u gjendën në shesh për të dëgjuar në radio Komunikatën e shkarkimit të Duçes. Për një moment mbetëm të topitur. I pari që e theu heshtjen ishte shqiptari Zai Fundo, ndoshta, se duke mos qenë italian emocionin e kishte më pak të fortë dhe ja ku thirri “Viva l’Italia libera” (ovacione) dhe kjo thirrje u mor pastaj nga të gjithë. Më pas Zai Fundo u kthye në Shqipëri, por Shqipëria nuk ishte gati për vizionin, idetë, ambicjen e tij që e çuan atë në varr shumë përpara kohe, djaloshin e dashuruar me Platonin dhe me Atdheun e tij, por të zhgënjyer nga komunistët që e kishin rrëmbyer me dhunën e diktaturës pushtetin e të gjithë shqiptarëve.

KOMENT: Më këmbëshpejtë është kryeministri kur i ikën detyrimeve të logjikshme në bisedën me diasporën. Çfarë ka thënë është kërcënim me stil për diasporën shqiptare me nëntekstin “Nëse ju do të ktheheni kini parasysh se mund ta pësoni si Zai Fundo. Ju e dini që Shqipëria është e çuditshme”. Ata që ndenjën në Itali u eci më mirë sesa Zait, ndaj rrinin me të mira, se po ua thotë vetë ai që e ka në dorë nëse do të jetë mirë apo keq nëse vini.”

CITIM: Shqipërisë iu desh të dilte jo vetëm nga terri i pambarimtë komunist por edhe të përshkonte vargmalet rraskapitëse të një tranzicioni të mosozotshëm për t'u rishfaqur më në fund në brigjet e Mesdheut europian si një shtet me zërin e vet dhe një vend me dinjitetin e vet, i cili sot pret e përcjell miq nga e gjithë Europa që nga miliona e miliona europianët që vijnë gjithnjë e më të shumtë për ta vizituar çdo vit deri tek dinjitarët më të lartë të cilët e shohin Shqipërinë gjithnjë e më shumë si Europën e vogël të Ballkanit akoma të trazuar (ovacione).

KOMENT: Le ta quajmë të vërtetë këtë pasqyrim (që nuk është aq), por a po u thotë shqiptarëve të diasporës *“Shih me sy dhe plas me zemër. Ju jeni pa atdhe. Ne që ju përzumë jemi me atdhe. Guri i rëndë në vend të vet”*. Kjo do të ishte nënteksti i hidhur.

Një pasqyrim i tillë i Shqipërisë “harrohet” të shoqërohet me ftesën *“Ejani, o shqiptarë, në Shqipëri. Hoqëm çfarë hoqëm, tani ai dolëm (!) dhe ju mund të vini në Shqipëri, para se të tjerët që mund të jenë të huaj të përfitojnë nga rasti që Shqipëria ka nevojë për krahë pune dhe ne të na ndryshojë struktura etnike”*. Kështu do të fliste dikush që Shqipërinë dhe shqiptarët i ka për zemër e jo me “tangërrllëk” (bëjmë edhe pa ju). Kujt i duhet se vijnë të huajtë, kur shqiptari i diasporës e ka hallin që shtëpinë e vet po ia merr i huaji, rrugën e vet po ia sheh i huaj, të afërmit të vet po i buzëqesh i huaji. Kryeministri kështu “ia hap edhe më shumë plagën” dhe ai e di këtë.

CITIM: Vitin e ardhshëm Shqipëria do të mikpresë në Tiranë që të gjithë udhëheqësit e komunitetit të ri politik europian nga Mbretëria e Bashkuar në Ukrainë dhe Moldavi, nga Norvegjia në Turqi, nga Portugalia në Azerbajxhan. Kush mund ta imagjinonte deri para ca vitesh këtë Shqipëri sot në arenën e madhe europiane e cila i ngjan gjithmonë e më shumë të gjithëve ju në familjen e madhe europiane, por Shqipëria sot pret dhe ju shqiptarët e Italisë dhe krejt botës si vendlindja juaj që rilind çdo ditë dhe që më në fund po bëhet shteti që kaq shumë i ka munguar shqiptarëve të Shqipërisë.

KOMENT: Për të shmangur absurdin e fjalimit gjendet edhe kjo fjali *“por Shqipëria sot pret dhe ju shqiptarët e Italisë dhe krejt botës si vendlindja juaj që rilind çdo ditë dhe që më në*

fund po bëhet shteti që kaq shumë i ka munguar shqiptarëve të Shqipërisë.” por këtë që është kryesore e ka renditur si dytësore dhe parësore është që Shqipëria është që do të presë kokat e politikës. Ai asnjëherë nuk e bën “programin e kthimit” kryefjalë dhe temë qendrore. Dy dhe vetëm dy gjëra do të duhej të diskutonte “programin e kthimit” dhe “programin e shqiptarizimit të diasporës”. Të tjerat do të ishin veç pasoja të këtyre programeve (kthim & shqiptarizim). Shkaku do të gjendej në ato programe. Të dyja programet mungojnë.

“Udha e shkronjave” ua ndau ambasadave tona në 29 tetor 2023 *“Programin edukativ të shkollave shqipe në diasporë”* dhe një pikë e këtij programi ishte *“programi i kthimit në atdhe”*. Nëse një shkollë shqipe që nuk ka autoritet shtetëror e bën këtë, mund të kuptohet sa absurde (në fakt e qëllimtë) është mungesa e këtij programi në programin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Pse ambasadat tona nuk ia japin udhëzimin se çfarë duhet të bëjë Qeveria e Shqipërisë me programin e kthimit dhe me programin arsimor të shkollave shqipe? Kjo ndodh sepse ato nuk i pyet kush dhe ato veç zbatojnë urdhërat e sektorit të Rilindjes brenda Partisë Socialite.

CITIM: Disa gojë nga ato që ju i njihni mirë thoshin këto ditë që unë nuk duhet të vija këtu sepse nën udhëheqjen time paskan ikur nga Shqipëria një milion shqiptarë. Kjo e një milion shqiptarëve të ikur dhjetë vjetët e fundit është një gënjeshtër e madhe e lig dhe e turpshme, njësoj si ajo e autobuzëve të ardhur nga Tirana e cila doli nga po ato gojë të pista duke i ofenduar në nderin dhe në dinjitetin e lartë patriotik që u shkrinë si lumi në det (ovacione) në atë përqaqim kuqezi të Athinës, për të treguar dashurinë për të shprehur mallin, për të manifestuar krenarinë e tyre, për shqiptarinë dhe për Shqipërinë (ovacione). Po, e vërtetë është, kanë ikur edhe në këto dhjetë vjet shumë shqiptarë shumë më tepër sesa janë kthyer, është e vërtetë, por Shqipëria e katandisur në 1.5 milionë banorë, Shqipëria e narkoshtetit, Shqipëria e mbytur në detin e korrupsionit, Shqipëria ku s'ka as punë as shpresë është një Shqipëri që ekziston vetëm në humnerën e atyre gojëve të cilat e përndjekin tokën e fëmijëve të Shqipërisë qysh kur Shqipëria shpalli pavarësinë në vitin 1912. (ovacione) dhe që prej asaj dite më të ligjtë e armiqve të vet Shqipëria i pati gjithmonë nga radhët e parisë së vet. (duartrokitje) Shumë e vërtetë është.

KOMENT: Sapo dëgjuesi do të rehatohet dhe të reflektojë në një mendim, kryeministri e tërheq zvarrë në një strukturë tepër të gjatë sintaksore fjalie, ku ka futur shumë ide e koncepte në një të vetme. Kjo për të shmangur ndonjë verifikim apo oponentë. Unë vetë kam shkruar artikullin “*Politizimi i diasporës është lajmi më i keq*” sapo mora vesh për turin. Fakti që po shkruajmë pas faktit dhe jo vetëm para faktit provon katërcipërisht që kjo që po ndodh është vërtetë lajmi më i keq. Kur unë e shkrojtja artikullin e parë, nuk kisha para fjalimin, pra nuk ishte bërë mitingu i parë në Greqi. Tani i kam fjalimet. Unë nuk jam duke analizuar se si u mbledhën njerëzit. U mor vesh që socialistët e bënë këtë punë. U mor vesh që e bën me “teknikat e fshehjes” nën rrogë. Por sidoqoftë ata vetëm morën pjesë dhe tashmë rëndësinë e merr mesazhi dhe pikërisht duhet analizuar mesazhi dhe jo vetëm forma e organizimit. Natyrisht forma ka një rëndësi tjetër që thekson dëshirën për të injoruar shoqatat patriotike, por le të përqëndrohemi tek fjalimi. Mesazhi është tepër dëmprurës se ai dekurajon kthimin dhe u thotë që nuk do të investojmë në arsim shqip. As në Greqi as në Itali nuk u zunë në gojë detyrimi për të mësuar e trashëguar gjuhën dhe kulturën shqiptare. Çfarë ka më të rëndë se kaq. Mundet ta themi duke cituar Sami Frashërin, në manifestin politik të Rilindjes Kombëare bazë e shtetit të ri shqiptar që u formua në 1912. Libri “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë”. Po citojmë kapitullin “Qëllim i shqiptarëve” ku tregohet se detyra e parë e shtetit shqiptar është “gjuha shqipe”. Ku e ka detyrën e parë Kryeministri i Shqipërisë kur flet me diasporën?! Viojmë me citimine Sami Frashërit

CITIJMË SAMI FRASHËRIN

5. Qëllim’ i shqiptarëve

“Qëllim i vetëm i shqiptarëve është të ruajnë Shqipërinë të mos copëtohet prej të huajve, **të mbajnë gjuhën’ e kombërin’ e tyre** t’u rrinë kundreq entrigavet t’armikëve të tyre e **të ndalojnë të përhapurit’ e gjuhëve të mendimeve të greqet e të shqehet**, të cilatë po i rëmojnë themeletë e po i nxjerinë rrënjët Shqipërisë dhe shqiptarërisë.

Çdo gjë që mund t’i sjellë dëm këtij qëllimi do të lëfthohet keq prej çdo shqiptari të vërtetë edhe prej lidhjes së shqiptarëve. Ato gjërëra, që do t’i ndihnin këtij qëllimi, do të zihenë me të dy duartë prej atyre e do të bëhenë me hir a me pahir.

M’e par’ e këtyre është gjuha; s’mund të ketë Shqipëri pa shqiptar, s’mund të ketë Shqipëtar pa gjuhë shqip, s’mund të ketë gjuhë shqip pa shkronja shqipe, pa shkolla në të cilat mund të mësohet shqipja. P’andaj më e parë nga të gjitha do të mbahetë gjuha, të shtrëngohetë qeveri e tyrkut ta grerë ndalinë, q’i ka vënë gjuhësë shqip e të lërë shkollat shqip të hapenë e livrat e fletoretë shqipe të hyjnë e të shkelenë çpënguarë në Shqipëri. **Çdo shqiptar të mësonjë më parë të shkruanj’ e të këndonjë shqip, pa pastaj gjuhëra të tjera.**

E dyta është kisha: të shpëtohenë shqiptarët nga xgjedha e priftërisë së greqet, të bullgarëve e të serbëve e të kenë kishën’ e tyre me priftër shqiptarë e me ungjill shqip; se Krishti s’ish as grek, as shqah.

Po për të bërë këto, duhet të qëndronjë (fjala “të hiqet”) qeveri’ e sotme, e të vihet një qeveri mëmëdhetare, një qeveri që të punonjë pas nevojës’ e pas të drejtave të shqiptarëve. Një qeveri shqiptare me sy të hapurë, e jo qeveri e huaj e e verbër si kjo q’është sot. të jetë një qeveri si duhetë pa le të ketë ç’emër të dojë.

Ky është qëllimi i shqiptarëve.

KOMENT: Ku e ka gjuhën shqipe kryeministri i Shqipërisë Edi Rama në fjalimet e tij në Greqi dhe Itali? Ku e ka kujdesin për shkollat shqipe në Greqi dhe Itali në fjalimin e tij? Një pjesë të shkollave tek të cilave investon aq sa të krijojë kontakte, duket se po i përdor vetëm si mjete survejimi politik të diasporës. Si respektohet detyrimi kushtetues i nenit 8, pika 3, që shprehimisht thotë: “3. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.”

A e do Shqipërinë me shqiptarë të diasporës? Atëherë duhet t’i mbajë si shqiptarë? Kush do ta bëjë këtë veç shkollave shqipe?! Atëherë pse nuk flet për këto me diasporën, por flet për “mullinjtë e erës” të markës “identiteti europian”, a thua se ka mbetur identiteti europian, në dorë të emigrantëve që përgjithësisht rrethanat i detyrojnë të jenë “mohim i çdo identiteti” dhe ajo që u mbetet është “identiteti i emigrantit”. Që të mos ndodhte kështu fjalimi dhe politika shtetërore do të duhej të përqëndroheshin saktësisht në këtë paragraf të Sami Frashërit ku shpjegohet “teknologjia më e lartë kombëtare” se “si kombi shqiptar mbetet komb”.

Më thjesht e kaq nuk ka, por Edi Rama e ka mendjen ta sulmojë Rilindjen Kombëtare dhe ta bëjë thjesht një “Rilindje” jo kombëtare, pa fjalën kombëtare nga nga pas. Edhe një herë citojmë Sami Frashërin:

Sami Frashëri: “Ato gjërëra, që do t’i ndihinë këtij qëllimi, do të zihenë me të dy duartë prej atyre e do të bëhenë me hir a me pahir. M’e par’ e këtyre është gjuha; s’mund të ketë Shqipëri pa shqiptar, s’munt të ketë Shqipëtar pa gjuhë shqip, s’munt të ketë gjuhë shqip pa shkronja shqipe, pa shkolla në të cilat mund të mësohetë shqipja”

CITIM I EDI RAMËS: Shqipëria ka një luftë të madhe për të bërë akoma edhe me korrupsionin edhe me krimin, edhe me të tjera plagë të trashëguara jo vetëm nga dekada e tranzicionit po nga shekujt ndarjeje të dhunshme prej Europës.

KOMENT: Hap një front të ri diskutimi për t’iu përgjigjur pyetjes “kush e ka fajin për korrupsionin” me synimin për të mbuluar faktin që përsëri i dekurajon të vijnë, duke u futur fakte negative. Edhe pse me korrupsion, ai duhet t’u thotë “*Ne kemi korrupsion, por edhe të tjerët kanë. Ata që bëjnë korrupsion ose janë fis im ose disa prej fisit tuaj. Eja e mund t’i ndaloni vetë me kulturën tuaj që keni fituar në perëndim*”. Një arsye pse emigrantët duhet të vijnë është pikërisht mentaliteti perëndimor që ata kanë në çështjet e sundimit të ligjit, pra ekzistenca e korrupsionit është një arsye më shumë se pse duhet të kthehen masivisht emigrantët. Shmangia e programit të kthimit provon se korrupsioni nuk është pasojë “e paparashikuar” por është program i qëllimshëm.

CITIM: Është askush që nuk e di historinë tuaj, askush që nuk e di historinë tonë po të shikonte atë film nuk nuk do ta besonte kurrë që ata njerëz atje jeni ju dhe si ata njerëz atje që sot jeni ju ashtu ishte Shqipëria dje që sot iu ngjan juve. Ama me të gjitha probleme e veta, Shqipëria ku drejtësia mbahej lidhur si qen gjahu me litarin e agallarëve të saj të paprekshëm, Shqipëria ku vriteshin çdo vit mbi 100 vetë dhe ku policët i shtynin makinat që mbeteshin pa benzinë rrugëve, Shqipëria ku turizmi mbahej vetëm nga patriotizmi dhe ku rrugëve kishte më shumë togje plehrash të pambledhura sesa turistë, Shqipëria ku ju, duhet të mer-

rnit rrugën mbrapsht, ta kalonit detin për të shkuar për të marrë një dokument dhe pastaj nuk dilnit dot nga sheshi i tragateve pa paguar policin e radhës ka vdekur, ka vdekur një herë e përgjithmonë, (ovacione), siç ka vdekur njëherë e përgjithmonë çdo shans që hijet e së shkuarës të rikthehen mbi kalë për ta shaluar në drejtim të paditur fatin european të Shqipërisë (ovacione). Mos e harroni në asnjë sekondë, përballë çfarëdo gjëje që nuk shkon se ka ndodhur diçka që në fakt është gjithçka që na është dashur për të arritur aty ku duam. Ka ndodhur që Shqipëria sot ka fituar besimin e botës dhe meriton edhe besimin e çdo shqiptari, besimin e çdo shqiptari si ju që e di shumë mirë se asgjë që arrihet me punë nuk arrihet pa mund, nuk arrihet pa sakrifica, nuk arrihet pa durim, nuk arrihet pa shtrenguar dhembët dhe kush më mirë sesa ju shqiparët e Greqisë, Italisë, Europës e di të vërtetën, e cila saç është e thjeshtë, aq është e pamundur që të kuptohet nga kushdo që punës nuk ia ka provuar peshën mbi supe, nuk ia ka njohur zhgënjimet mundit, nuk ia ka ndjerë dhimbjen sakrificave, nuk ia ka kaluar sprovat durimit dhe po iu them “Atij që do besojë tek Shqipëria e sotme, Shqipëria e nesërme do t’ia kthejë shumëfish besimin”.

KOMENT: Vini re “teknologjinë moderne të komunikimit”. Jep idenë se jeni shumë afër të të thënit “Kthehu!” por përsëri nuk e thotë. Kjo do të thotë që “të nderohet” për çfarë tha, por ama t’ua ketë shtirë mirë “frikën” nëse i bëjnë planet “pa hanxhinë”. Ai nuk jep asnjëherë siguri për kthimin dhe kjo gjithashtu kuptohet nga fjalimi i tij.

CITIM: I kam sjellë këtu këto rreshta për ju se duken si të shkruara tamam për ju, për shqiptarët e kësaj kohe vështirësisht të reja për Italinë dhe për Europën e zhvilluar se ju jetoni këtu se ju e dini shumë mirë se sa shumë janë vështirësuar gjërat, por edhe mundësisht të reja për Shqipërinë që sot mund të zhvillohet si kurrë më parë.

Janë fjalë të ndjera nga panegjiriku e Perandorit Anastas Durrësakut: “*Ty fati sikur ta kishte parashikuar të ardhmen të dhuroi atdheun që ua kalon të tjerëve nga lumturia sepse Epidamni (Durrësi) i këndonë shqiptarët dhe bashkë me ta buçet për të fama si një qytet që zgjatet nga Toka në det dhe që banohet në secilin nga të dyja e që me tepricë ka nga ato*

që mund të prodhojë toka dhe deti sepse këtu është e mundur që njerëzit të jenë njëkohësisht banorë të ishullit dhe të kontinentit dhe t'u qëndrojnë larg të këqiave që vijnë nga të dy duke gëzuar si njërin si tjetrin”

Por, ndryshe nga ata që vijnë nga deti, nga toka nga ajri dhe që Shqipëria e sotme i mikëpret, me bujarinë e saj legjendare për çdo të huaj në pragun e shtëpisë së shqiptarit ju vini sot në një Shqipëri që është shumë ndryshe nga ajo që latë kur ikët nga sytë këmbët dhe padyshim që Shqipëria sot është një shtëpi që ka akoma shumë gjera për të vënë në vend e shumë punë për të mbaruar, por mos e harroni pikërisht pse ajo është e tillë, ka edhe shumë mundësi për këdo, që kthehet me dijet me eksperiencën, me kursimet e vete dhe që, duke pas mësuar guximin do të fitojë për veten dhe familjet më shumë sesa ata që ngurojnë se shpirti ua do por ndërkohë mendohen dhe presin presin që ta gjejnë gati (ovacione) dhe tjetra ai që do të kthehet më shpejt do ketë më shumë vite përpara në paqe për shpirtin e ndarë më dysh që kur shkon atje e ke këtu dhe kur je këtu e ke atje. (ovacione) **por ju nuk jeni të detyruar, nuk jeni aspak të detyruar të zgjidhni o njërin o tjetrën** mes të dyjave Italisë dhe Shqipërisë sepse sot ju e keni të mundur t'i përkisni të dyjave, jo vetëm si deri tani këtu me punë dhe me halle, andej me zemër dhe me njerëz, por edhe me zemër edhe me punë, edhe këtu edhe atje. (ovacione).

KOMENT: Ka një arsye që salla e inkurajoi me duartrokitje pas frazës që i çoi deri tek burimi, pra afërsisht ajo që po kërkonim (monitoronim) ta shihnim në fjalimet e tij, mirëpo sapo mendoj lexuesi se kryeministri *u rehatua* në kapitullin “*programi i kthimit*” ai i thotë qëllimisht “*por ju nuk jeni të detyruar*”. Duket se edhe aq sa guxoi e i tha ishin të matura me peshore farmacisti që të mos mungonte si zë. Ai e di shumë mirë që nëse një Qeveri Shqiptare do t'u thotë emigrantëve “*Ktheuni tani se është koha për t'u kthyer*” shumë prej tyre do ta marrin udhën e kthimit. Puna është që këtë nuk e di vetëm ai dhe shqiptarët, por e dinë edhe qeveritë e Greqisë, të Italisë, të Gjermanisë, të Britanisë së Madhe që qartësisht nuk kanë interes në kthimin e diasporës së kulturuar shqiptare në atdhe, sepse Shqipëria do të jepte modelin se si diasporat do të ishin në gjendje të ngrinin fuqishëm shtetet e tyre dhe kjo do të ishte një konkurrencë e vërtetë për këto shtete dhe jo vetëm me origjinë shqiptare.

Ndaj besoj ka një interes të lartë politik në turin e Edi Ramës dhe në “bujarinë” e këtyre shteteve për t'i lënë territorin për të thënë këtë fjalim nën tundjen e flamujve kuq e zi.

Klasa jonë politike siç ndjen erën e parasë së madhe, ndjen erën edhe të “kauzave” me të cilat mund të luajë rëndshëm. Ndërkohë që Edi Rama bën këtë, një personazh i klasës politike të opozitës thotë “do ta bëj Shqipërinë me 4 milionë” e një tjetër thotë “do të ndikoj të kthehen butë”. Ky përdorim i ulët kur kanë interes, na ka bërë të themi që diaspora duhet ta vendosë në karantinë Shqipërinë, derisa ajo vetë ta shërojë atë.

CITIM: Askush më mirë se ju nuk ia di fjalës punë. Askush më shumë se ju nuk di dijes së fundit dhe të drejtës së djerësës (?!), parasë së fituar e të kursyer me shumë sakrificë në një dhe që dje ishte i të huajit ndërsa sot është edhe i juaji, prandaj askush më mirë se ju nuk do t'ia dilte dot me punë, mund dhe guxim që ta rriste ekonominë e familjes së vet duke u investuar dhe atje në dheun që u nxori në det si të huaj, por që ka qenë është dhe do të mbetet atdheu juaj (ovacione).

KOMENT: Kuptohet nga reagimi i sallës (ovacione) që këtë drejtim të bisedës kanë pritur, por ai e ka thurur në atë formë fjalinë që individi të mos marrë asnjë argumentim shtesë. Ashtu si e ka thënë, i ka thënë “*merrni rreziqe po erdhët në Shqipëri, por ju ia keni marrë dorën përderisa keni shkuar në Itali*”. Ia kujton edhe një herë në mënyrë të gabuar “*dheun që u nxori në det si të huaj*” që nuk është e vërtetë, sepse “*dheu i ka nxjerrë me lot*” dhe jo “*si të huaj*”. Kujt i thotë të “huaj”?! Nënave që janë në Shqipëri. Është klasa politike, por klasa politike nuk është “atdheu”. Janë dy gjëra të ndryshme. Ai qëllimisht zëvendëson njërin me tjetrën. Këtë e bën për të rritur frikën, megjithatë salla e kuptoi që ajo duhej të ishte biseda. Por bisedën ai e ka llogaritur me peshore farmacie. Ai e di që fjalimi do të hyjë në analizë dhe do të lërë gjurmë justifikimi.

CITIM: Koha e mirë e Shqipërisë më në fund ka ardhur, motra dhe vëllezër dhe vetëm në shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve të saj, brenda dhe jashtë kufijve të politikës, brenda dhe jashtë kufijve të së mundurës mund dhe do ta bëjmë këtë kohë një kohë që do të shënjohej në historinë e vendit tonë siç u shënua në historinë e shqiptarëve në Europë koha juaj **koha e ribashkimit përfundimtar me familjen europiane** (ovacione të matura që do të thotë se prisnin diçka tjetër).

KOMENT: Qëllimisht është evaziv dhe nuk thotë me statistika “Na mungojnë kaq mësues, kaq inxhinierë, kaq mjekë, kaq infermierë, kaq ndërtesues, kaq ushtarakë, kaq kompjuteristë etj. etje.” Kjo është “koha e mirë”, por ai nuk jep informacion, sepse e di që informacioni është ndihmues për kthimin. Natyrisht që jo çdo gjë bëhet vetëm përmes fjalëve të kryeministrit dhe nuk po themi se vetëm fjala e tij është vendimmarrja që duhet të bëjë një emigrant. Përkundrazi, megjithëse kjo është përmbajtja, emigrantët duhet të kthehen në vendet e tyre dhe nuk duhet të marrin parasysh dekurajimin (nëse ky fjalim për ta është dekurajues, për mua është). Sapo salla mendon se pas togfjalëshit “koha e ribashkimit përfundimtar” do të vinte “me atdheun”, Edi Rama i jep një kthesë të fortë dhe thotë “me familjen europiane” dhe atëherë salla që kishte bërë gati duartrokitjet i filloi dhe i zbehu. Lexuesi të ndjekë edhe një herë videon dhe mund të kuptojnë edhe nga kaq thelbin, pavarësisht se ata që ishin në sallë ishin socialistë dhe e kishin ndarë mendjen që çfarëdo të dëgjonin do të duartrokisnin, por gjatë fjalimit, ka edhe reagime të sinqerta dhe ky ishte një i tillë.

CITIM: “Unë erdha në Durrës për arsye se ky është edhe qytet ilir dhe besnik ndaj meje dhe i vendosur afër Italisë”, shkruante Ciceroni, qysh në kohën e Romës dhe kështu vijon tani në Shqipëri edhe udhëheqësit e Italisë që gjejnë atje një vend krenar, dhe një vend besnik ndaj Italisë më të cilën marrëdhëniet tona janë ato të miqësisë të respektit, të partneritetit të veçantë.

Sot në Shqipëri jetojnë afro 20 000 italianë dhe numri i tyre rritet çdo javë, siç raportojnë, burimet e brendshme italiane, ndërkohë që afro 1000 të reja e të rinj italianë studiojnë në Shqipëri. Numri i bizneseve italiane është rritur dhe po i afrohet 3000, ndërkohë që gjithnjë e më shumë italianë vijon në Tiranë për fundjavë.

KOMENT: Kryeministri nuk thotë dot që 20 000 shqiptarë janë kthyer nga emigracioni. Si shpjegohet? Cilat janë statistikat e kthimit? Kryeministri e tha në mënyrë evazive “ka më shumë që ikin sesa ata që vijnë”, por tek italianët qenkan më shumë ata që vijnë sesa ata që ikin. Kush e bën këtë të mundur veç Qeverisë së Italisë? A mund ta bëjnë këtë italianët pa një udhëzim e politikë të qartë të vetë Italisë? Nga ta dijë publiku shqiptar nëse dekurajohen shqiptarët që të vijnë italianët?! Kush i inkurajoi italianët? Kush i dekurajon shqiptarët?

CITIM: Ju e dini më mirë se kushdo dhe lëre pastaj se mediat, e kafenetë në Shqipëri që sa shumë është shtrenjtuar jeta juaj këtu në Itali që sa ndjeshëm është rritur pasiguria për të nesërmen, madje që edhe sa vështirë është të shëtisësh lirisht pa frikë natën në zona të caktuara të qyteteve të mëdha dhe ndërkohë unë kam vetëm një ftesë për t’ju bërë të gjithë shqiptarëve që punojnë në hoteleri – turizëm apo në shërbime të ndryshme këtu në Europë. Informohuni vetë, informohuni drejtpërdrejt, jo nga ekranet, jo nga kanalet e mbushura me vrer politike dhe me lajem të rreme, informohuni se sa janë realisht pagat në sektorin e shërbimeve në Shqipëri, sa merr realisht dikush që punon në hoteleri dhe secili pastaj e bën vetë llogarinë, por ju siguroj se kush vjen i armatosur me dijen e aq shumë profesioneve dhe zanateve për të cilat sot zhvillimi i Shqipërisë ka aq shumë nevojë është i fituar.

KOMENT: Kryeministri kapi vetëm një sektor të ekonomisë, që ka nevojë urgjente për krahë pune. Kjo është për t’u dhënë me nënkuptim që sektorët e tjerë janë në rregull. A janë emigrantët të interesuar vetëm për sektorin e turizmit, apo edhe për sektorë të tjerë dhe mbi të gjitha mbi kushtet e përgjithshme të shtetit. Qëllimisht u la e pasqaruar që të ketë një farë “rreziku” brenda. Nuk dha atë që duhet “shteti ynë do të jetë i drejtë” dhe nuk do t’u lodhi, siç po lodh masivisht ata që po largohen nga Shqipëria që vetë kryeministri pohoi se janë “më shumë sesa ata që vijnë”, pra bilanci është negativ.

CITIM: Dhe me mirënjohjen më të madhe për durimin që më dëgjuat kaq shkurt se unë flas gjatë (duartrokitje) dua ta mbyll me një fjalë të nxjerrë nga një dedikim. Se nuk ka vend, nuk ka rast, nuk ka mesazh më të mirë sesa sot unë

të ndaj me ju dedikimin e akteve të Koncilit të Arbërit në korrik të vitit 1703, ku Imzot Vincent Zmajevic i shkruan Atit të Shenjtë Papës Klementi XI, biri shqiptar i familjes shqiptare Albani:

“Ti më urdhërove o At i Shenjtë Papë t’i vizitohet dhe t’i vë re si vizitor apostolik kishat e Shqipërisë, dheut tim, nën hijen tënde, o Shenjti Atë Papë. Dheu i Shqipërisë po gazmohet se pas shumë vjetësh po zë të marrë frymë dhe po çel sytë. Kjo Shqipëri që tash sa mot ka ndenjtur si e harruar dhe e mbuluar e varfëra prej mjegullës nën një Papë shqiptar po del në dritë dhe mezi pret të fitojë namin dhe lumninë e moçme. Pëlqej, pra, o i lumnueshmi Atë, lutjet tona, nderimin më të përvuajtur dhe gazmendin e Shqipërisë sime, madje më mirë të them Shqipërisë sate” (ovacione)

KOMENT: Në kuadër të asimilimit, sipas vendit edhe kuvendi. Vendi është i krishterë, hajde të themi gjëra të krishtera. Mbase janë në rrugën e konvertimit në të krishterë, meqë Italia është një vend katolik. Le të bëhen çfarë të duan veç shqiptarë të mos mbeten.

Asnjë porosi, asnjë këshillë, asnjë udhëzim, motivim, frymëzim nuk pamë për gjuhën dhe kulturën shqiptare, por pamë skedat e çoreintuara me citime andej-këndej.

CITIM: Mbarësia qoftë gjithmonë pranë jush, pranë familjeve tuaja, të afërme dhe miqve tuaj.

Rroftë Shqipëria dhe shqiptarët.

Viva l’Italia e vivano gli italiani

KOMENT: Edhe pse duket një urim normal, kjo nuk ishte një “qokë” e ndonjë grupi shqiptarësh të veçuar, por ishte një takim përmes të cilit ai po i fliste të gjithë diasporës. Për çfarë i takoi Kryeministri i Shqipërisë dhe Kryetari i Partisë Socialiste? Për qokë apo për të ndikuar tek ta dhe ata që ishin jashtë sallës dhe të gjithë shqiptarëve që dëgjojnë gjithandej.

Përfundimisht mbetem i mendimit që mesazhi kryesor i takimit në Greqi dhe Itali ishte dekurajimi i kthimit dhe nxitja e asimilimit të plotë.

VINI RE EMRAT DHE KONCEPTE TË PËRDORURA GJATË FJALIMIT

Është një mënyrë e shkurtër për të kuptuar se nga sillet biseda me diasporën shqiptare të Italisë. Ajo është e ngopur mjaftueshëm me emra dhe tematika italiane ose italo-shqiptare, ndaj ka arsye që në një miting të fryrë me flamuj kuq-e-iz të marrë “aromë kulture shqiptare” nga kryeministri dhe të trajtohet diaspora shqiptare si e tillë (shqiptare) dhe jo vetëm si diasporë italo-shqiptare.

FJALOR ITALIAN, I HUAJ, KONVERTIME QËLLIMISHT I PASUR ME EMRA

Papa Klementi XI, Perandori Anastas Durrësaku, Imzot Vincent Zmajevic, Familja Albani, Ciceroni, Koha e Romës, Dante Aligheri, Virgjili, Enea, Musolini, Ventotene, Altiero Spinelli, At i Europës së Bashkuar, Xhorxhia Meloni, Shën Pali, Jul Qezari, Pompeu, Amalfi, Venecia, Napoli, Paolo Veronese, simbol i rezistencës veneciane, Durracët e Xhenovas, Risorgimento, Krispët, Gramshët, Pulja, Siçilia, Mbreti i Napolit, Atleti i Krishtit, Selia e Shenjtë, Eleni, Andromaka, Troja, Roma, Komedia Hyjnore, Cacciaguida, La Scala, Fletrini, Einaudi, Bienale e Venecias, Sanremo, Umberto Bosi, Kanali i Otrantit, Jakov Filip Follmerajër.

“FJALORI” SHQIPTAR QËLLIMISHT I VARFËR

Zai Fundo, Gjergj Kastrioti, Arbëri, Butrinti.

PA KOMENT

KOMENTE PËRFUNDIMTARE NË KËNDVËSHTRIM TË NENIT 8 TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

NENI 8

1. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj.
2. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet.
3. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.

KOMENTE:

Pika 1. Në fakt, fjalimi i Edi Ramës i shkoi mbarë “asimilimit” dhe “të drejtave kombëtare të popullit grek dhe italian” që kërkon të ketë fuqi punëtore shqiptare dhe është i interesur në një asimilim sa më të shpejtë.

Pika 2. Të mbrosh nuk do të thotë “të vajtosh” por të luftosh për t’i fituar të drejtat. Ai shpiku një “luftë inekzistente” e tipit “E stato albanese” dhe bëri sikur “ai” po luftonte, kur në fakt, thjesht po pasqyronte se si e kishin kaluar këtë periudhë shqiptarët krejt vetëm dhe pa ndonjë mbështetje domethënëse nga shteti shqiptar. Kur foli për ndryshim emrash, ai nuk e bëri këtë për të mbrojtur por thjesht për ta bërë objekt “vajtimi” humbjeje, pra “mos e mbani mendjen këtu”, po shkojmë para (drejt humbjeve të reja, siç është asimilimi).

Pika 3. Si ia siguroi ndihmën diasporës shqiptare dhe shtetasve shqiptarë Edi Rama në fjalimin e tij që ata të mundën të ruajnë e të zhvillojnë lidhjet me trashëgiminë kulturore shqiptare? Pikërisht kjo pikë e tretë mungon masivisht në fjalimet e tij në Greqi dhe Itali, që do të thotë një braktisje e detyrimit kushtetues. Vetë fjalimi do të duhej të ishte “investim” për gjuhën shqipe, por ai investimin e mbajti për politikën e ij.

PROGRAMI I KTHIMIT NË ATDHE “UDHA E SHKRONJAVE”

Pjesë e programit edukativ të shkollave shqipe që u është ndarë ambasadave, shkollave shqipe dhe organizimeve patriotike në diasporë.

Në 29 tetor 2023, ne u nisëm të gjitha ambasadave tona Programin Edukativ të Shkollave Shqipe.

Nuk morëm përgjigje, as ndonjë mirënjohje formale apo ftesë për thellim e diskutim rreth temës. Mesazhi i ambasadave është i qartë “mos u merrni me të tilla punë”.

Fjalimi i Kryeministrit provon saktësisht se në cilin drejtim po punojnë ambasadat e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare.

Është në vlerësimin e lexuesit të gjykojë nëse e shohin si kombëtare apo jo.

Këtu po se jllim vetëm faqen 15 të Programit Edukativ të Shkollave Shqipe që përmban **programi e kthimit në atdhe**.

Me këtë duam të provojmë që analiza që po shkruajmë këtu për fjalimet e Edi Ramës nuk janë “shih e shkruaj”, në kuptimin “sajo kritika” por qartësisht po i kërkojmë atë që vetë e kemi bërë. Pra nuk po i kërkojmë diçka që vetë nuk e kemi bërë.

Programi edukativ i shkollave shqipe është edhe i botuar në faqen e shkollës sonë.



OLIMPIADA XXIII
KOMBËTARE 2023
GJUHË SHQIPE

Programi i kthimit në atdhe i shkollës shqipe

Shkolla shqipe duhet ta ketë për objektiv programin e kthimit në atdhe. Kjo gjë nuk varet nga objektivat e prindërve dhe të nxënësve konkretë. Për shumë arsye ata nuk mund të kthehen, por shkolla bën punë të vazhdueshme për kthimin. Kthimi nuk është fare i lehtë. Ai del po aq i vështirë sa është edhe largimi nga atdheu. Ashtu si prindërit janë përgatitur me vite për t'u larguar, edhe tani duhet të përgatiten me vite për t'u kthyer. Për t'u larguar u është dashur të mësojnë anglishten, gjermanishten, italishten etj. Tani për t'u kthyer duhet t'u mësojnë fëmijëve gjuhën shqipe, duhet të përgatiten kulturalisht për kthimin. Këtu shkolla shqipe do të gjejë veten, detyrat e saj.

Duke hartuar programin e kthimit në atdhe shkolla shqipe bashkohet me objektivat kombëtarë. Shkolla ofron ndihmën e saj kulturore dhe bashkëpunimin e saj që familjet të bëhen të vetëdijshme, që komuniteti të ndihmojë e të bëjë mbarë një familje apo grup familjesh që të kthehen. Duhet të ndihmojnë të gjithë dhe të tërheqin njëri-tjetrin drejt atdheut.

Shumë shpejt shkollat shqipe do të kenë modele të programeve të kthimit. Pjesë kryesore e programit të kthimit është frymëzimi kombëtar. Kjo është një punë e hollë, dhe e gjerë që i kërkon shkollës shumë mësim, veprimtari, projekte, biblioteka, komunikim e bashkëpunim të gjithanshme. Arsyet për largim të njerëzve nga Shqipëria kanë qenë të shumta, por më të mëdha do të jenë tani arsyet për kthim në atdhe. Kthimi do ta përmirësojë jetën shqiptare, sepse të kthyerit do ta bëjnë punën e tyre me më shumë dëtim e profesionalizëm, dhe me më shumë dashuri, e cila mund të mos kuptohet nga vendasit që nuk kanë lëvizur ndonjëherë nga vendi për një periudhë të gjatë. Është e qartë se tjetër është turizmi e tjetër është emigracioni.

Pikë kyçe e suksesit të shkollave shqipe do të jetë forcimi i fiseve shqiptare të cilat janë shkërrmoqur duke u shpërndarë, ndaj kthimin do ta quajë se është një objektivi fisnor. Askush nuk kthehet nëse kupton që të gjithë fisin e ka jashtë atdheut dhe nuk ka kush e pret në Shqipëri.

Shumë shpejt shkollat shqipe me programet e tyre të kthimit në atdhe do të vendosin nën stres organet lokale e qendrore në Shqipëri, por ky do të jetë stres pozitiv, sepse rezultati do të jetë me përfitim të madh kombëtar.

Ekzistenca e programit të kthimit kthehet në një mbështetje të fuqishme psikologjike që shkolla shqipe bashkë me komunitetin u bën anëtarëve të saj, që vazhdimisht do të jenë në tundimin “të kthehen apo jo”.



Gjuha shqipe

Flamuri kombëtar nuk ka shka ban nder ne,
Po kje se dashuni nuk kem p'r Atdhet
Gjergj Fishta

**PJESË NGA PROGRAMI EDUKATIV
“UDHA E SHKRONJAVE”
PËR SHKOLLAT SHQIPE
NË DIASPORË**

Ngjitur është programi ynë se çfarë propozojmë se duhet të bëjnë shkollat shqipe në diasporë në drejtim të edukimit të vetëdijes kombëtare.

Në 29 tetor 2023, ne u nisëm të gjitha ambasadave tona Programin Edukativ të Shkollave Shqipe.

Nuk patëm ndonjë komunikim prej tyre.



OLIMPIADA XXIII
KOMBËTARE 2023
GJUHË SHQIPE



**Shkolla Shqipe
si Faltore e Bujarëve Shqiptarë**

Shkolla shqipe jashtë atdheut tregon kujdes në çështjen fetare. Jashtë atdheut faltoret janë kryesisht të huaja dhe ndiqen nga grupe mikse të kulturave të ndryshme. Shpesh bëhet problem për prindërit të ndjekin një shkollë shqipe, nëse kuptojnë që drejtuesit e saj anojnë nga një besim i caktuar fetar.

Në këtë pikë shkolla shqipe duhet të jetë e përgatitur t'u edukojë nxënësve çështjen fetare shqiptare dhe ta bëjë këtë hapur sipas devizës së Rilindjes Kombëtare “Besa e shqiptarit është shqiptaria” (Pashko Vasa).

- a) *për libër të shenjtë* le të jetë përmbledhja e frymëzimeve të poetëve të Rilindjes (një pjesë e keni këtu),
- b) *për profet* të kenë Naim Frashërin (sipas Lasgush Poradecit dhe thujse të gjithë poetëve shqiptarë, por edhe të publikut të gjerë), për figura të tjera hyjnore afërsisht me të njëjtin status si të Naimit, le të jenë Pashko Vasa, Lasgush Poradeci, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Mitrush Kuteli. Naimi është simbolikisht në krye, por duhet ditur që rilindasit punojnë në grup dhe skemën e punës në grup e jep Lasgush Poradeci në “Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri” (1946).
- c) *për rite të besës* le të kenë ritet e nderimit të datave dhe figurave kombëtare, dhe
- ç) *për identifikim*, le të identifikohen si “bujarë shqiptarë” që ndjekin “besën”
- ç) *për faltore të bujarëve shqiptarë* të kenë shkollën shqipe apo shoqatat patriotike shqiptare ku ata edukohen
- d) *për simbolikë identifikuese* le të kenë duart si shqiptarë

Nuk është me shumë rëndësi që t'i kushtohet rëndësi anës formale (pra referimit në termat “besim” apo fjalës “fetar”), por prindërit, fëmijët e komuniteti shqiptar duhet ta dinë se shkolla shqipe ua mbulon këtë nevojë fetare në mënyrën më të bukur, më të shëndetshme, më funksionale dhe shqiptare, pra u jep orientim në bazë të ideve të Rilindjes Kombëtare. Nëse për ta ka rëndësi misioni i shkollës shqipe, ata duhet ta pranojnë këtë pozicionim të shkollave shqipe dhe ta quajnë si fatin më të madh që mund t'u ndodh fëmijëve të tyre. Orientimi universal pastaj në faltore të tjera është një këndvështrim tjetër që sigurisht ka vlerën e vet, sidoms në respektimin e traditës së shtetit ku vepron shkolla shqipe.

Ky koncept i shkollës shqipe i kënaq të gjithë shqiptarët. Familjet pra i dorëzohen konceptit përbashkues të rilindasve dhe aq u del e u tepron edhe për orientim fetar. Ky forcim ideologjik shqiptar, do t'i bëjë fëmijët mjaft të fuqishëm nga ana ideore. Çdo botëkuptim fetar ka nevojë për traditën kombëtare dhe nxënësit shqiptar në cilëndo faltore do të rrezatojnë të njëjtën qasje që shkolla shqipe u mëson, qofshin këta fëmijë të traditës së krishterë apo muslimane, do të dinë t'i përgjigjen pyetjes kyçe “Si ia arrini ju shqiptarët të keni harmoni fetare?”. Sot për sot, as në Shqipëri, nuk dihet mirë se si t'i përgjigjesh kësaj pyetje, që tregon një mospërgatitje të shkollave dhe të brezit të ri, gjë që çënon rëndë të ardhmen e tyre në çështjen fetare, sepse mund të biben pre e skemave konvertuese nga një fe në tjetrën.

Shkolla natyrisht respekton drejtimin fetar tradicional të çdo familjeje dhe familjet po ashtu e kuptojnë shkollën shqipe në ato që u mëson fëmijëve dhe në ndjesitë që ajo edukon.

ROLI I MËSUESVE SHQIPTARË SI FIGURA QËNDRORE TË KOMUNITETE- TIT DHE FINANCIMI I SHKOLLAVE

Në 29 tetor 2023, ne u nisëm të gjitha ambasadave tona Programin Edukativ të Shkollave Shqipe.

Në faqen 17, të këtij programi gjendet një artikull të veçantë me titull “Mësuesit shqiptarë, figura qendrore të komunitetit (diasporë) dhe financimi i shkollave shqipe (të diasporës)”



OLIMPIADA XXIII
KOMBËTARE 2023
GJUHË SHQIPE

MËSUESIT SHQIPTARË figura qendrore të komunitetit dhe financimi i shkollave

Që shkolla shqipe të ketë sukses, duhet të jenë mësuesit në krye të komuniteteve. Mësuesi shqiptar që ka edhe licensimin e shtetit ku vepron shkolla duhet të jetë qendror për një shkollë shqipe. Ai/Ajo duke qenë i ditur për procedurat, programet, ligjet, programet, veprimtaritë vendore do të ketë më shumë mundësi të drejtojë si duhet nxënësit shqiptarë. Nëse familja do të ketë sukses me programin e kthimit në atdhe si një program shumë i lartë, mësuesi shqiptar i shkollës shqipe kthehet në frymëzuesin kryesor të fëmijës dhe e përgatit atë sipas interesit konkret që prindërit deklarojnë.

Nga ana tjetër, mësuesit janë profesionistët e duhur për të ndërtuar komunitete të pastra shqiptarësh në harmoni me pjesën vendase, larg nga dukuritë negative. Vetë shteti i huaj ka më shumë besim në shoqata që drejtohen nga mësues që vetë ai i ka licensuar, ndaj çdo shoqatë vendore duhet t'i ketë mësuesit në krye.

Të gjithë duhet të ndihmojnë mësuesit shqiptarë. Problemi i madh i shoqatave shqiptare është se ato duke dashur të jenë “me dyer të hapura për të gjithë” rezultojnë të kenë një reduktim të madh dhe praktikisht nuk bëjnë asgjë. Problemi i madh i emigracionit është gjuha dhe trashëgimia kulturore dhe për gjuhë dhe kulturë duhet të jenë mësuesit në krye. Synimi kryesor janë fëmijët dhe trashëgimia kulturore. Ndërkohë që fokusi është tek gjuha dhe kultura, mësuesit shqiptarë do të japin edhe një mbështetje të fuqishme psikologjike dhe në edukimin e tipareve të personalitetit. Ata do të bashkëpunojnë në emër të prindërve me shkollat ku ndodhen fëmijët, do të monitorojnë punën e tyre, do të trainojnë prindërit për të shmangur dukuritë negative.



Gjuha shqipe

FINANCIMI I SHKOLLAVE SHQIPE

Nëse prindërit e shohin problemin kështu, pra e shohin kështu rolin e mësuesit, kaptohet që duhet të përgatiten që t'i mbajnë mirë mësuesit shqiptarë dhe të investojnë tek ta.

Ekziston një video-regjistrim në youtube “Financimi nga buxheti familjar i gjuhës shqipe është interes kombëtar” (Artur Shkurti, 28 nëntor 2022).

Familjet shqiptare janë përfituese kryesore të shkollave shqipe dhe duhet të jenë edhe financueset kryesore. Ush jep fondet, ka edhe përparësinë që të ndikojë programet e edukimit. Komunitetet do të përfitojnë edhe nga oferta bujare e shteteve të tyre për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, por nuk duhet ta quajnë të mjaftueshme.

Ideja kryesore është që shkollat shqipe nuk mund të shpësojnë vetëm në paratë që merren nga projektet dhe familjet duhet ta kaptojnë që me financimin e shkollave shqipe janë duke financuar në mënyrë të pavarur një institucion shqiptar. Nëse shkolla i merr paratë nga diku tjetër, është e sigurtë që do të bëjë programin e atij që jep paratë.

Komunitetet duhet të bëhen të afta të blejnë ndërtesë për shkollat shqipe apo për veprimtarinë e tyre. Shkolla shqipe ka nevojë për arshivë, për bibliotekë, për mjete mësimore, për muze dhe të gjitha këto duan ndërtesë. Nuk mundet të shpësojnë vetëm në godina me qera.




GLOBAL ALBANIA



udha e shkronjave

KONCEPT
NGA ARTUR SHKURTI





SHKOLLA “UDHA E SHKRONJAVE”

**Adresa: rruga “Qemal Stafa”, 124, Tiranë
Cel: 0692076068**

www.udhaeshkronjave.com